



Certifikimi me Global GAP, i bën sipërmarrësit, eksportues të suksesshëm në rajon e më gjerë

Faqe 4



Kultivimi i sfungjerit - Inxhinieri që la naftën për bujqësinë

Faqe 5



Education Farm - Fermat Edukative nga Kopluku në Ksamil

Faqe 5



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit prill 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 436
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

BUJQËSIA HALLKË KRYESORE NË PRODHIMIN E ZINXHIRIT USHQIMOR

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM NË TRYEZËN TEMATIKE: "BUJQËSIA, TURIZMI RURAL DHE MJEDISI NË ZONAT RURALE NË SHQIPËRI"

Prioritetet, avantazhet, mundësitë dhe disa probleme të Bujqësisë, Turizmit Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale, janë disa nga çështjet kryesore që adreson për diskutim dhe zgjidhje tryeza tematike, organizuar nga KASH, me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm të linjës, nga institucionet e ndryshme dhe sektori privat

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Punësimi i të rinjve, mbahet në Tiranë Konferenca Kombëtare "Rëndësia e aftësive në tregun e punës si një forcë lëvizëse për rritjen e atraktivitetit të rrjetit të AFP-së"



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



BASHKËPUNIM

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ndërmjet

SHOQËRISË KURSIM KREDI "FED invest" & KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"

Faqe 6

KËNDI I EKSPERTIT

- Humbja nëpërmjet urbanizimit dhe industrializimit të tokës bujqësore Fq.11
- Tokat e kripura, shtrirja dhe alternativat e përmirësimit të tyre Fq.11
- Kalendari bujqësor, muaji maj 2022 Fq.13

Krifca - Maître: Adresim sfidave në sektorin e bimëve aromatike dhe fruta-perimeve

Qeveria zvicerane do të mbështesë bujqësinë shqiptare në forcimin e kapaciteteve në zinxhirin e vlerës për sektorin e bimëve aromatike dhe mjekësore dhe fruta-perimeve...



Faqe 2

TEME E DITES

Çmimet e perimeve të serrës - Fermerët në Lushnje: Po dalim me humbje



Faqe 4

LEGJISLACION

Draftligji "Për bletarinë", regjistrim edhe kur ke 1 koshere, masat mbështetëse dhe kontrolli

Faqe 5

RISI ALBANIA

Punësimi i të rinjve, mbahet në Tiranë Konferenca Kombëtare “Rëndësia e aftësive në tregun e punës si një forcë lëvizëse për rritjen e atraktivitetit të rrjetit të AFP-së”

Arsimi profesional po reformohet në Shqipëri dhe për këtë qëllim sapo u zhvillua një konferencë. Politikëbërës, ekspertë, partnerë ndërkombëtarë dhe më e rëndësishmja brezi i ri, u mbledhën për të diskutuar mbi hapat e mëtejshëm dhe të qëndrueshëm në këtë drejtim, një angazhim më kuptimplotë dhe sistematik të sektorit privat si dhe përafrimin e aftësive dhe arsimit profesional me tregun e punës.

Në një treg pune gjithnjë në ndryshim, aftësitë e kërkuara pasqyrojnë dinamikën e tregut. Aftësitë e reja të kërkuara përfshijnë aftësitë njohëse dhe socio-emocionale, aftësitë dixhitale, aftësitë e gjelbra, aftësitë e buta, aftësitë e përbëra, aftësitë sipërmarrëse dhe të menaxhimit

të karrierës.

Projekti RisiAlbania ka qenë

ipëri, me temën “Rëndësia e aftësive në tregun e punës si një



një nga kontribuesit kryesorë të sesionit të tretë të Konferencës Kombëtare të AFP-së në Shq-

forcë lëvizëse për rritjen e atrak-

(Vijon në faqen 4)

Thirrje për shprehje interesi për ngritjen e “Zyrave të Shërbimit të Këshillimit të Karrierës” në nivel vendor

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe RisiAlbania shpallin “Thirrjen për shprehje interesi” për ngritjen e “Zyrave të Shërbimit të Këshillimit të Karrierës” në nivel vendor.

Kjo thirrje për shprehje interesi vjen në vijim të punës së projektit RisiAlbania, i cili synon të ofrojë më shumë mundësi punësimi për të rinjtë dhe të rejtat në Shqipëri, nga mosha 15-29 vjeç, në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Një nga fushat ku është fokusuar projekti është zhvillimi i shërbimeve të karrierës për të përmirësuar qasjen e të rinjve ndaj mundësive, informacionit dhe shërbimeve të tregut të punës. Për këtë qëllim projekti ka punuar për rritjen e kapaciteteve të institucioneve ofruese të shërbimit të karrierës (si bashki, universitete, ofrues privatë), për rritjen e kapaciteteve të këshilluesve të karrierës dhe për zhvillimin e përmbajtjes / informacionit mbi tregun e punës dhe mjeteve të nevojshme (si teste vlerësuese karriere).

RisiAlbania është një projekt i mbështetur nga Agjen-

cia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, në partneritet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe zbatohet nga Helvetas dhe Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Aktualisht projekti ka hyrë në fazën e tij të tretë (1 Nëntor 2021 – 31 Tetor 2025).

Qëllimi i kësaj thirrjeje është shtrirja e shërbimeve të qeverisjes vendore në mbështetje të të rinjve për tu orientuar drejt karrierës së suksesshme dhe mundësive për punësim. Modeli i ngritjes së zyrës për këshillimin e karrierës është pilotuar aktualisht në Bashkinë Tiranë. Prej vitit 2021, zyra është funksionale dhe ofron mundësi vetë-shërbimi, këshillim karriere individual, këshillime dhe trajnime ne grup. Përmes kësaj thirrjeje për shprehje interesi, Partnerët Shqipëri dhe RisiAlbania, në bazë të një procesi vlerësimi do të përzgjedhin 3-4 Bashki të cilat do të përfitojnë nga skema e mbështetjes për ngritjen e zyrave të këshillimit të karrierës në nivel vendor.

Për më shumë informacion gjeni si më poshtë:

• **Udhëzuesin për Bashkitë**

– i cili jep informacion mbi qëllimin e thirrjes dhe procesin e shprehjes së interesit

• **Aneks 1** - Informacion mbi shërbimet e Zyrave të Këshillimit të Karrierës

• **Aneks 2** - Formularin për Shprehjen e Interesit

• **Aneks 3** - Deklarata për tu nëshkruar nga Titullari i Bashkisë Partnerët Shqipëri dhe RisiAlbania do të zhvillojnë 2 sesione informimi dhe 3 vizita studimore në Zyrën e Këshillimit të Karrierës në Tiranë

Shënim:

Referojuni kalendarit indikativ për datat e vizitave studimore dhe dërgoni në adresën e email: jalite@partnersalbania.org datën në të cilën do të merrni pjesë.

Partnerët Shqipëri dhe RisiAlbania do të koordinojnë vizitat studimore në datat përkatëse.

Afati i fundit i dorëzimit të paketës së shprehjes së interesit është data 3 qershor 2022, brenda orës 17.00.

Paketa e shprehjes së interesit duhet të dërgohet elektronikisht në adresën e email: jalite@partnersalbania.org

Krifca - Maître: Adresim sfidave në sektorin e bimëve aromatike dhe fruta-perimeve

Qeveria zvicerane do të mbështesë bujqësinë shqiptare në forcimin e kapaciteteve në zinxhirin e vlerës për sektorin e bimëve aromatike dhe mjekësore dhe fruta-perimeve.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca priti në një takim në ambientet e Ministrisë, ambasadorin e Zvicrës në vendin tonë, Adrian Maître.

“Diskutuam mbi mbështetjen e qeverisë zvicerane ndaj bujqësisë, rugëtimin e zhvillimit dhe përafrimit të sektorit me Bashkimin Europian”, u shpreh Krifca.

Krifca shprehu entuziazmin se “brenda majit, me mbështetjen e përfutur nga Zvicra, do të fillojmë projektin më të ri të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që do të adresojë sfida në forcimin

e cilësisë dhe kapaciteteve në zinxhirin e vlerës për sektorin e bimëve aromatike dhe mjekësore dhe fruta-perimeve”.

Bimët aromatike mjekësore

shqiptare dhe janë ndër më të kërkuarat në tregjet ndërkombëtare.

Adresimi i mbështetjes për rritjen e cilësisë së tyre sipas



dhe perimet e freskëta janë dy nga sektorët kryesorë që kryesojnë eksportet bujqësore

standardeve më të mira, është një vlerë e shtuar për ekonominë dhe nxitjen e punësimin.

Gra rurale të suksesshme

Në gazetën “Agrobiznesi” është hapur një rubrikë të re që i dedikohet Grave sipërmarrëse në sektorin e bujqësisë.

Në çdo numër të gazetës do të dedikojmë histori të ndryshme të krijimit të sipërmarrjeve rurale që drejtohen nga gratë, duke sjellë tek ju përmes intervistës artikull, historinë e biznesit të ngritur nga gratë.

Cilat janë kuriozitetet tuaja më të mëdha në lidhje me gratë në sipërmarrje? Cilat janë pyetjet që do të donit t’i bënit atyre? Cilat janë bizneset për të cilët do të donit të dinit më shumë? Apo doni të sillni dhe ju historinë tuaj si një shembull frymëzimi për fermeret e tjera, na kontaktoni përmes facebook të gazetës “Agrobiznesi”.

Infermiere në profesion, Engjellushë Pepaj është grua aktive në grupin e grave përpunuese të Qelëz, si dhe në aktivitete të tjera që organizohen në zonë. Së fundmi ajo po sjell një risi në Pukë dhe zonat rurale përreth, ku para disa javësh inaguroi serrën për prodhimin e fidanëve, me të cilën Engjellushja synon të furnizojë zonën e Qelzës dhe më gjerë në Pukë.

Prej vitesh Engjellushja advokon për rritjen e mirëqenies së grave në Qelëz dhe gjithashtu drejton grupe Rrethi Studimi ku u mëson grave të komunitetit praktika të thjeshta për kujdesin shëndetësor.

Agro Puka, një shoqatë prej 300 fermerësh po bën 20 vjet që nga krijimi i saj. Ndër vite shoqata AgroPuka ka mbështetur fermerë të zonës së Pukës dhe Fushë-Arrëzitet drejtimin e prodhimit dhe përpunimit të produkteve që mund të kultivohen në zonë. Praktikata e promovuara gjatë kësaj kohe, kanë qenë gjithmonë pranë natyrale dhe sidomos mospërdorimi i kimikateve të dëmshme për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme në blegtori dhe bujqësi. Gratë e kësaj zone prodhojnë produkte bujqësore dhe blegtorale duke ruajtur traditën pukjaneve, cka i bën këto prodhime të veçanta

dhe të kërkuara nga tregjet urbane. Të bashkuara në shoqatë, fermeret angazhohen për t’u organizuar e kooperuar së bashku e për të forcuar njëra-tjetrën në sipërmarrjen rurale. Ky lloj bashkëpunimi i ndihmon ata të prodhojnë tok, të mesojnë nga njeri-tjetri, të certifikojnë produktet, të shtojnë vlerë e të marrin çmime më të larta. “Unë mendoj vërtet se bashkimi bën fuqinë e fermerëve dhe do të punoj fort që ky model bashkimi të shërbejë si shembull e të shumëfishohet në rajone të tjera bujqësore në vend, sepse së bashku jemi më të fortë”, shprehet Engjellushja.

THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI PËR NGRITJEN E ZYRAVE TË SHËRBIMIT TË KËSHILLIMIT TË KARRIERËS NË NIVEL VENDOR

AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM: 3 QERSHOR 2022

RisiAlbania Partner for Growth

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



BUJQËSIA HALLKË KRYESORE NË PRODHIMIN E ZINXHIRIT USHQIMOR

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM NË TRYEZËN TEMATIKE: “BUJQËSIA, TURIZMI RURAL DHE MJEDISI NË ZONAT RURALE NË SHQIPËRI”

Prioritetet, avantazhet, mundësitë dhe disa probleme të Bujqësisë, Turizmit Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale, janë disa nga çështjet kryesore që adreson për diskutim dhe zgjidhje tryeza tematike, organizuar nga KASH, me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm të linjës, nga institucionet e ndryshme dhe sektori privat

Bujqësia konsiderohet dhe rezultojnë në fakt një nga sektorët jetikë e prioritar të Ekonomisë Ushqimit, si dhe një ndër hallkat kryesore të prodhimit në zinxhirin ushqimor në Shqipëri.

Sektori i bujqësisë karakterizohet nga një strukturë mbjellësh dhe prodhimtarie në vite si vijon: **(Shih tabelen nr. 1 dhe 2, faqe 8).**

Shqipëria ka akoma rezerva për shtimin e sipërfaqes së tokës produktive, që kultivohet me bimë arash, si grur, misër, tagjira, elb, sojë, me synim për të reduktuar importin dhe me agrume, perime, luleshtrydhe dhe bimë mjekësore e aromatike, me qëllim për të rritur eksportin.

Këshillat të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), në bazë të disa sondazheve të kryera i ka rezultuar se përveç rezervave të rritjes së prodhimit nga këndvështrimi intensiv përmes rritjes së rendimentit, me shumë pak investime prodhimi mund të rritet edhe nga ripunimi dhe rikultivimi i 100 mijë ha të tjerë sipërfaqe të tokës produktive, që mund të kultivohet me bimët e sipërcituara. **(Shih tabelen nr. 3, faqe 8).**

Pyetjet që shtrohen dhe kërkojnë përgjigje:

A duhet të fokusohemi më shumë tek rritja e rendimentit në serrat ekzistuese, apo do të vazhdojmë me rritjen e sipërfaqeve?

A duhet të mbështesim rritjen e sipërfaqes dhe prodhimit të perimeve në serra përmes metodës së hidroponisë?

A mundemi të certifikojmë prodhimin e perimeve të destinuar për tregun e vendit me certifikatën Lokal GAP dhe për eksport me certifikatën Global Gap?

*Çfarë iniciativash të tjera duhen ndërmarrë nga sektori privat dhe ai publik për të ulur koston e prodhimit të perimeve? **(Shih tabelen nr. 4, faqe 8).***

Prodhimi perimeve në serra dhe në fushë të hapur vlerësohet nga ekspertët ka avantazhe shumë të mëdha veçanërisht për rritjen e efikasitetit së përdorimit të tokës bujqësore dhe për rritjen e eksportit.

Drufrutorët mbas një procesi stanjacioni e tranzicioni të gjatë e të vështirë, aktualisht po rriten e zhvillohen me ritme të shpejta në Shqipëri. Pro-

dhimi i fidaneve cilësore dhe të certifikuar në vend mbetet një sfidë që duhet tejkaluar pa humbur kohë. Ekzistojnë mundësitë dhe potencialet për investime efikente, për një rritje të ndjeshme, si në sasi të numrit të rrënjëve dhe rendimentit/rrënjë dhe nga grupi drufrutorëve do të veçonim:

Arrorët mbasi kemi akoma sipërfaqe toke djerrë që mund të mbillet me arrorë.

Ulliri potencialet dhe mundësitë më të mëdha për rritjen e efikasitetit së investimeve të kryera deri tani i ka tek rritja e rendimentit/rrënjë dhe përmirësimi cilësorë së vajit.

Agrumet janë në një proces rritjeje të vazhdueshme dhe ka akoma rezerva për shtimin e llojshmërisë së varieteteve, numrit të rrënjëve dhe rendimentit/rrënjë.

Vreshtat dhe pjergullat gjithashtu kemi potenciale të papërdorura, rezerva dhe mundësi, për të investuar në mbjelljet e reja, duke rritur si sipërfaqen dhe rendimentin, për prodhimin e rrushit në ambiente të mbrojtura, veçanërisht atë për konsum të freskët. **(Shih tabelen nr. 5, faqe 9).**

Prioritetet, avantazhet, mundësitë dhe disa probleme të Bujqësisë, Turizmit Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale:

Shqipëria ka patur dhe do të vazhdojë të ketë si prioritet edhe në të ardhmen, përmirësimin dhe konsolidimin e veprimtarisë në sektorin e **Bujqësisë**, si një ndër sektorët jetikë dhe kryesore të **Ekonomisë** së Ushqimit.

Avantazhet e Shqipërisë për zhvillimin e bujqësisë, turizmit rural dhe përmirësimin e mjedisit në zonat rurale janë të lidhura ngushtë me:

Tokën në tërësi dhe atë bujqësore në veçanti, ujin, klimën, mjedisin, pyjet, livadhet, kullotat, energjinë, mekanizimin, inovacionin, dhe dixhitalizimin, financat, mikrofinanca, disbursimin e fondeve grant, përmirësimin e legjislativionit, integrimin rajonal dhe atë Euro atlantik.

TOKA

Shqipëria ka gjithsej 2.8 milion ha tokë, nga e cila në vitin 1990 rezultonte se 699.021 ha ka qenë tokë bujqësore ose

24 % e totalit, që ishte kultivuar në vite, ndërsa livadhet e kullotat kanë zënë 16 %, tokat (inproduktive, urbane, sip. ujore të brendshme) kanë zënë 15 %, pyjet 36 %, ndërsa kategori të tjera 9 %.

Struktura e mësipërme e tokës ka ndryshuar në mënyrë kaotike mbas vitit 1990, pa asnjë program dhe kontroll, duke e zvogëluar ndjeshëm sipërfaqen e tokës bujqësore në tërësi dhe sipërfaqet e kultivuara të tokës bujqësore në veçanti.

Shqipëria mbas shkrirjes së Institutit të Tokës nuk ka bërë studime dhe analiza dobiprurëse, si dhe nuk ka përdorur instrumente të tjera, për ndjekjen dhe monitorimin e ndryshimit të strukturës dhe përdorimit eficient të tokës në tërësi dhe tokës bujqësore në veçanti. Të ardhurat bruto të fermerëve për 1000 ha tokë bujqësore në Shqipëri janë më të ulëta në rajon dhe 4 herë më pak nga ajo që përfitojnë fermerët psh në Izrael.

Pyetja që shtrohet dhe kërkon përgjigje:

A duhet programuar të realizohet dhe të vihet në zbatim sa më parë një studim, ku të analizohet e identifikohen saktë problemet dhe t'i jepet zgjidhje efikente strukturës dhe përdorimit të tokës në tërësi dhe atë të tokës bujqësore në veçanti?

Çfarë duhet bërë akoma më shumë që të nxitet tregu i shitblerjes së tokës bujqësore në Shqipëri?

Shqipëria përsa i përket sipërfaqes së tokës/banor është e disavantazhuar jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë, sepse renditet ndër vendet me sipërfaqen më të vogël të tokës bujqësore / banorë. Gjithashtu në dallim nga vendet e rajonit po përballet dhe po vuan disa pasojë negative që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë ligji 7501 dt 19.07.1991“Për Tokën”, si atë të copëzimit në 1.8 milion parcela, mungesën për një kohë të gjatë të certifikimit të tokës bujqësore, të emigrimit masiv veçanërisht të të rinjve nga zonat rurale dhe lëniën djerrë të rreth 100 mijë ha tokë produktive, të braktisjes së pronës, si dhe të mungesës së investimeve të domosdoshme, që duheshin kryer deri tani kryesisht në zonat rurale për tokën etj.

Pyetjet që shtrohen dhe kërkojnë përgjigje:
A duhet adresuar edhe me

një ligj dhe akte nënligjore të posaçme përgjegjësi për dëmin që i shkaktohet sigurisë ushqimore dhe asaj kombëtare të shqiptarëve nga lënia djerrë dhe braktisja e tokës bujqësore produktive?

A duhet filluar pa humbur kohë ndërtimi një modeli dobiprurës, fillimisht përmes një projekti pilot, për të futur në rrugën e zgjidhjes problemin e moskonsolidimit të tokës dhe parcelizimit të tejskajshëm të saj në 1.8 milion parcela?

A duhet filluar pa humbur kohë të bëhet një studim specifik dhe të propozohet e merren masa për vlerësimin e produktivitetit të tokës bujqësore, rezervave ujore, të pyjeve, kullotave, dhe livadheve të lëna djerrë në të gjithë vendin?

A mund dhe duhet rikthyer përsëri në funksion të plotë si ka qenë Instituti studimit të tokës në Shqipëri?

UJI

Shqipëria renditet si më e avantazhuara në Ballkan dhe më gjerë për hidrografinë, për burimet dhe rezervat e pastra dhe të pasura ujore. Burimet ujore nga shiu dhe ato nëntokësore në veçanti, në shumë zona nuk shpërndara në të gjithë territorin e vendit. Shumë prej tyre plotësojnë standartet e cilësisë për t'u konsumuar direkt nga burimi si nga njerëzit dhe nga kafshët, përveç përdorimit për ujitje. Gjithashtu shërbejnë edhe si burim për prodhim energjie elektrike të pastër nga hidrocentrale të vegjël, kryesisht në zonat ku nuk shtrihet rrjeti i shpërndarjes së energjis elektrike.

Harta hidrografike përbëhet nga 6 laguna të përmasave të ndryshme, 5 liqene të përmasave të mëdha dhe 247 liqene artificiale të llojeve dhe përmasave më të vogla, me një sipërfaqe të përgjithshme ujore prej 1210 km.2 dhe me vëllim të përgjithshëm të ujërave prej afro 60 miliardë m3 ujë/vit.

Janë ndërtuar në vite me fonde nga buxheti i shtetit, që mund të përdoren akoma 670 rezervuarë për ujitje. Gjithashtu janë të evidentuara mbi 200 burime ujore nëntokësore, me një prurje mesatare gjithëvjete prej 200 l/sek. secili.

Shqipëria ka 8 lumenj kryesorë që furnizohen nga 152 degë lumenjsh të vegjël, të cilët derdhen në detin Adriatik dhe Jon pa u përdorur mesatarisht 39 miliardë m3 ujë/vit.

Lumi Vjosa është lumi i vetëm në Europë, që e ka ruajtur deri tani abiatin e vet natyror, pa u prekur nga ndërhyrjet e ndryshme dhe ka qenë e do të vazhdojë të jetë mjaft dobiprurës edhe për ujitjen pa e cënuar abiatin e vet natyror.

Shqipëria përveç ujit për vaditje ka edhe disa lloje burimesh me ujëra termale të cilat shërbejnë si qendra kurative.

Relievi i tokës bujqësore, infrastruktura e ujitjes dhe potenciali i pasur ujqor gjithëvjeter i ka mundësuar dhe i mundëson Shqipërisë ujitjen e mbi 400 mijë ha tokë bujqësore.

Potencialin dhe rezervat ujore që kemi nuk po i përdorim sa dhe si duhet. Rezervë kemi akoma edhe për rreth 110 mijë ha tokë bujqësore që nuk ujitet por mund të ujitet.

Rëndësia dhe problemet e ujitjes njihen, sepse kemi një strategji të miratuar për ujitje dhe kullimin nga viti 2019 deri në vitin 2031.

Pyetjet që shtrohen dhe kërkojnë përgjigje:

Çfarë duhet bërë akoma më shumë nga secili aktor përgjegjës dhe i interesuar për zhvillimin e bujqësisë që të zbatohet strategjia 2019 – 2031 e miratuar për ujitjen dhe kullimin?

A duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen financimi i projektit për ujitjen dhe kullimin nga Banka Botërore ose donatorë të tjerë?

A është llogaritur sa është dëmi i shkakuar nga ndërpreja e investimeve në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit dhe, A mund të justifikohet ulja e ndjeshme e financimit në buxhetin e vitit 2022 në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit?

A duhet analizuar dhe rishikuar përsëri strategjia që është ndjekur për konsolidimin e Organizatave të Përdorimit të Ujit?

KLIMA

Shqipëria ka një klimë mesdhetare me mbi 300 ditë në vit me diell, me rreshje mesatare vjetore që sipas vendndodhjes gjeografike variojnë nga 722 mm deri në 2750 mm. Rrëshjet e shiut dhe dëborës variojnë nga 120 – 135 ditë/vit. Pozicioni gjeografik i favorshëm bën që Shqipëria të laget nga dy dete, deti Adriatik dhe deti Jon. Vija bregdetare është me gjatësi 450 km përfshirë Lagunat.

Klima, uji dhe toka bujqësore në Shqipëri e ka favorizuar

ndjeshëm kultivimin e perimeve në serra dhe në fushë të hapur dhe mundëson daljen në treg në pranverë një muaj përpara konkurrenteve në vendet e rajonit. Gjithashtu, për arsye të klimës, ujit dhe tokës, ka qenë i avantazhuar prodhimi dhe eksporti i bimëve mjekësore dhe aromatike, ullirit, frutave, agrumeve, rrushit, arrorëve, etj.

Vitet e fundit sektori bujqësisë po përballet me probleme dhe dëme të mëdha që janë shkakuar nga ndryshimet periodike dhe përkeqësimi i klimës. Dëmtime të konsiderueshme që llogariten rreth 147 milion euro në vit, vlerësohet edhe nga Banka Botërore, kanë ndodhur në bujqësi nga thatësira dhe zjarret masive, nga breshëri, rënia e rreshjeve intesive brenda një kohe të shkurtër, të shoqëruara me përmbytje dhe me një erozion të tokës në rritje. Gjithashtu në rritje ka qenë dëmtimi i bimëve nga insektet dhe sëmundjet.

Komuniteti ndërkombëtar është mjaft i shqetësuar dhe po alokon fonde të konsiderueshme miliarda euro dhe dollar grant, për procesin e parandalimit të pasojave që vijnë për shkak të përkeqësimit të klimës.

Pyetjet që shtrohen dhe kërkojnë përgjigje:

Çfarë masash parandaluese specifike duhen marrë në bujqësi nga sektori privat dhe ai publik, për të parandaluar e minimizuar dëmtimet nga ndryshimet dhe përkeqësimi i klimës?

Sa dhe si ka ndikuar kompensimi i fermerëve dhe subjekteve me fonde nga buxheti, për dëmtimet e shkakutara nga fatkeqësitë natyrore?

A duhet të hartohet një ligj i posaçëm për siguracionet në bujqësi dhe sektorët e Ekonomisë Ushqimit, kush duhet ta marrë iniciativën dhe kur?

Çfarë përgatitjesh dhe masa paraprake duhen marrë, që Shqipëria të përfitojë nga fondet prej miliarda euro dhe dollarë grant, që po programohen për t'u vënë në dispozicion nga shtete të fuqishme dhe institucionet financiare ndërkombëtare, për parandalimin e pasojave që vijnë nga përkeqësimi i klimës?

PYJET, LIVADHET, KULLOTAT:

Sektori bujqësisë është i

TEMA TË DITËS

Emigrojnë edhe fermerët - Mungesa e fitimit dhe e mbështetjes financiare i detyron që të lënë tokat

Një dekadë më parë Gjok Gjoka, nga Hani i Hotit hoqi dorë nga linja e transportit me kamionë, për t'u marrë me pu-

që kudo është e vështirë, siç do punoj atje do punoj edhe këtu. Kur vjen puna tek bujqësia, babë e bir janë gjithnjë bash-

likon? Thotë je 3000-5000 në radhë çfarë është këtu gara e vrapimit."

Ndryshe nga babi, Andi beson se të rinjtë mund t'i kthejnë sytë nga toka me fare pak vëmendje nga ministria e bujqësisë.

"Jo vetëm ne, por të gjithë fermerët në Malësinë e Madhe kanë nevojë për mbështetje, subvencionime, uljen e çmimit të naftës."

Për Andin largimi i moshatareve të tij nga fshati nuk është shumë shqetësues, pasi dita e tij është e zënë pasi kthehet nga shkolla djalin e ri e thërret bujqësia.

Sa shokë ke në lagje?

"Në lagje vetëm një ka mbet të tjerët kanë ikur. Në fshat të



kë", tha Andi.

"Bujqësinë kam filluar ta

nët e bujqësisë. Fillimet e tij si fermer që kultivon bimë medicinale qenë të mbara. Por sipas Gjokës sherebela në këto dy vite është shitur me një çmim që mbulon kostot dhe që nuk të sjell fitim. Ndryshimi i të ardhurave në fund të muajit, bëri që familja e Gjokës të zvogëlohej. Nga 6 anëtarë, kjo familje mbeti me 3 pjesëtarë.

"Unë kam 4 fëmijë. Vajza e madhe është në Itali, vajza tjetër është Kanada, një djalë e kam që shkon e vjen në Itali. Po ky i vogli kam dëshirën që të mos lëvizë dhe e ka pasion bujqësinë dhe i është përkushtuar vetëm bujqësisë".



pëlqej që kur babi filloi të merret me të", shtoi ai.

Por dashuria e të birit për tokën, sipas Gjokës duhet ushqyer me politika mbështetëse nga Ministria e Bujqësisë, që deri më tani nuk kanë qenë të duhurat. Sipas tij shteti duhet të mbështesë të gjithë fermerët, pavarësisht renditjes dhe sipërfaqes.

"Unë kam 11 vite që merrem me bujqësi mund të kem bërë 5-6 herë aplikime dhe unë se kam marrë një qindarkë. Përse çfarë të thonë kur ap-

gjithë kanë ikur jashtë. Shumë pak kanë mbetur."

Nuk e ke menduar kurrë të ikësh nga këtu?

"Jo nuk ka ndonjë ide që më vjen në mendje."

18-vjeçari planet për të ardhmen i ka të qarta, sapo të përfundojë maturën do të shkojë në universitet për të ndjekur studimet në degën e menaxhimit të biznesit, e më pas do të rikthehet sërish në fshat, po kësaj herë me një vizion të ri për fermën.

Çmimet e perimeve të serrës - Fermerët në Lushnje: Po dalim me humbje

Fatmir Arapi ka kultivuar domate të cilën po e shet me çmimin 150 lek kilogrami.

Fatmir Arapi, fermer: Spërkatjet janë të shtrenjta, do ju hedh ta marrin nga bima por është shtrenjtë. Në muaj i bie goxha pleh, do pleh të hajë

kjo. Bedri Cekrezi thotë se këtë vit çmimet kane ndryshuar duke nisur që nga fidanët me 10 lek me tepër ndërsa inputet bujqësore janë trefishuar. Nëse një sperkatje vitin e kaluar kushtonte 2400 lek, tani shkon

në 6 mijë. Por një tjetër problem mbetet abuzimi me çmimin e shitjes, ku sipas fermerëve ate e vendos tregtari. Ata shprehen se nëse domatja nga serrat e tyre del me çmimin 160 lek në Tirane ajo shitet me 300.



FATMIR ARAPI - FERMER



BEDRI CEKREZI - FERMER

Certifikimi me Global GAP, i bën sipërmarrësit, eksportues të suksesshëm në rajon e më gjerë

Shtetet e Bashkuara janë krenarë që vazhdojnë të mbështesin agrobizneset shqiptare për t'u rritur dhe zgjeruar jashtë vendit! Projekti për Ekonominë, Zhvillimin, Qeverisjen dhe Rritjen e Ndërmarrjeve të USAID/Albania ndihmoi Agro Divjakën, një biznes familjar shqiptar, të marrë Çertifikimin Ndërkombëtar të Standardeve

Ushqimore Global G.A.P. (Praktika të Mira Agrikulturore) dhe duke u bërë një eksportues i suksesshëm rajonal dhe global i pjeprit, shalqinjve, karotave, lakrës, brokolit, lulëlakrës dhe luleshtrydheve shqiptare. Ky certifikim e ndihmoi kompaninë të rriste vëllimin e shitjeve nga vetëm 7 - 8000 ton deri në 12 000 - 13 000 ton në vit, si dhe të

përmirësonte cilësinë dhe sigurinë ushqimore të produkteve bujqësore, duke rritur vlerën e produkteve bujqësore si dhe qasjen në Bashkimin Europian dhe tregje të tjera me vlerë. Suksesi i tyre ndihmon edhe 400 deri në 500 fermerët në zonën e Divjakës, produktet e të cilëve kompania Agro Divjaka i eksporton jashtë vendit.



Rënia e krerëve në blegtori çon në rekord importet e mishit më 2021

Rënia e numrit të krerëve të bagëtive (kryesisht dele, lopë dhe dhi) me rreth 20% në pesë vitet e fundit përveçse po ndikon në rritjen e çmimeve të prodhimeve vendase, mishit dhe bulmetit, po përkeqëson bilancin tregtar me jashtë. Vitin e kaluar, importet e mishit shënuan rritje të mprehtë, duke arritur rekord në dy dekadat e fundit, sipas të dhënave të INSTAT.

Në vitin 2021, importet e mishit shënuan 43,8 mijë tonë, me rritje 9% me vitin pandemik 2020 dhe 6.4% në raport me vitin normal 2019. Kompanitë importuan me çmime të lira gjatë 2021 pasi importet në vlerë në 5 vitet e fundit nuk paraqesin ndryshim të qenësishëm, teksa sasia e tyre po vjen në rritje të dukshme gjatë viteve të fundit.

Importet e mishit pritet të

rriten më tej gjatë viteve në vijim, për dy arsye themelore.

E para lidhet me rënieën e shpejtë të numrit të bagëtive. Sipas të dhënave nga Ministria e Bujqësisë, numri i fermave që mbarështojnë më shumë se 5 lopë është reduktuar nga 4,250 ferma (në vitin 2015) në 3,472 ferma (në vitin 2019), duke konfirmuar vështirësitë e fermerëve me rritjen e kostove të inputeve dhe ushqimit, koston e lartë të punimit të tokës dhe çmimit të ulët të qumështit. Edhe numri i gjedheve për mish po përjeton të njëjtin trend negativ, ndërsa ferma mesatare është gjithashtu shumë e ulët 2.48 gjedhë/fermë. Gjithashtu numri i deleve dhe dhive ra me nga 18% secila në 5 në periudhën 2015-2020.

Së dyti, importet e mishit do të nxiten nga rritja e kërkesës

për shkak rritjes së numrit të turistëve. Gjatë vitit të kaluar kanë vizituar vendin rreth 5.7 milionë vizitorë të huaj. Numri i vizitorëve po rritet me ritme dyshifore nga viti në vit, teksa kërkesa për mish po rritet nga baret dhe restorantet.

Mishi është baza e recetave tradicionale në vendin tonë. Altin Prenga që zotëron njësitë e agroturizmit, Mrizi i Zanave ka pohuar se furnizimi me mish vendi po bëhet gjithnjë e më vështirë dhe me kosto të lartë.

Rritja e çmimit të mishit që shërben si lëndë e parë pothuajse për të gjitha restorantet në vend, ndikon në rritjen e çmimeve finale në këto njësi.

Gjithashtu, rënia e krerëve ishte një ndër faktorët kryesorë për rritjen me rreth 20-40% të çmimeve me pakicë të bulmetrave.

Punësimi i të rinjve, mbahet në Tiranë Konferenca Kombëtare "Rëndësia e aftësive në tregun e punës si një forcë lëvizëse për rritjen e atraktivitetit të rrjetit të AFP-së"

(Vijon nga faqja 2)

tivitetit të rrjetit të AFP-së".

Duke kontribuar në një panel kushtuar "Rëndësia e aftësive

të rrjetit të AFP-së", znj. Edlira Muedini Menaxher i Projektit të RisiAlbania dha kontributin e saj mbi rëndësinë e aftësive të menaxhimit të Karrierës në AFP

e shërbimit të guidencës në karrierë në Shqipëri.

Konferenca dyditore Kombëtare adresuar tregut të punës në Shqipëri, erdhi si një përpjekje e përbashkët e të gjithë aktorëve dhe partnerëve kryesorë dhe shërbeu si një hapësirë e përbashkët e inventarizimit të arritjeve, sfidave dhe rugës përpara të reformës së vazhdueshme në sektorin e zhvillimit të aftësive.

Konferenca u organizua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në partneritet me Bashkimin Evropian në Shqipëri dhe Agjencinë Zvicerane për Bashkëpunim për Zhvillim (SDC), Ambasada e Zvicrës në Shqipëri me mbështetjen e Programit të Zhvillimit të Aftësive për Punësim të UNDP-së në Shqipëri.



në tregun e punës si një forcë shtytëse për rritjen e atraktivitetit

dhe më gjerë, si dhe për arritjet dhe sfidat e lidhura me ofrimin

Kultivim pa plehra kimikë, më pak perime në Kuçovë, fermerët: Qeveria të ulë çmimet ose largohemi nga vendi

Çmimi i plehrave kimikë është kthyer në shqetësimin kryesor për fermerët e Kuçovës, një ndër zonat më prodhuese në vend si për perimet në sera ashtu dhe për drithërat. Ata kërkojnë që qeveria të ndërhyjë në treg për uljen e çmimeve ose t'u japë subvencione

Fermerët e fshatrave Kozare dhe Zdravë në Kuçovë kanë kultivuar perimet në sera, por prodhimi është i dobët për shkak se nuk kanë hedhur

Një tjetër shprehjet: Kam 4 vjet punë në serra një thes pleh për kultivimin e domates vjet ishte 50 mijë lek sot në 75 mijë lek për domaten e kam fjalën

jellë tokat me grurë thonë se nëse qeveria nuk ndërhyr me subvencione pritet rritje e çmimeve në treg.

"Kemi mbjellë grurë elb jonxhë dhe terfil për lopët. Çmimet janë trefishi, urene e merrnim me 45 dhe sivjet 130 po dhe DAP-i po ashtu, nuk diskutohet se do rriten çmimet. Grurin e kam për bukë, elbin për lopët".

"Kosto për të punuar tokën me zetar është rritur, vjet kush-tonte 15 mijë lek për shkak të naftës ka shkuar 25 mijë dynymi. Shteti të ulë çmimet ca apeli tjetër!"

Në Shkodër shoqata e fermerëve kërkon nga Ministria e Bujqësisë të rishikojë tarifën për tregun e shumicës.

"Të ulët tarifa në të kundërt do të dalim në protesta deri në bllokimin e hyrjes së tregut", tha Ahmet Sylejmani, zvpresident i 'Shoqatas e fermerëve Shkodër'.

Aktualisht fermerët e Shkodrës për të shitur në tregun e shumicës paguajnë 150 mijë lek në vit.



plehtrat kimikë.

"Ne po falimentojmë! Nga 35 mije urea dhe DAP-i kanë shkuar në 130, ndërsa nitrati me 100 mijë lek thesi. Shiko ca punojmë me mjete primitive. Ti shes e të iki në Greqi. Qeveria të ulë çmimet kjo na detyron të ikim", tha një fermer.

sot i bie të mos kultivojmë e të ikim jashtë. Kam marrë dhe kredi nuk e përballoj dot, me rritjen e çmimit kostoja del më lart. Shteti subvencion vetëm pikat e grumbullit dhe shpërndarjes së fidanëve ne si fermerë s'na jep asgjë".

Edhe fermerët që kanë mb-

Education Farm - Fermat Edukative nga Kopliku në Ksamil

Në mbështetje të politikave të qeverisë për nxitjen e zhvillimit rural, ekspertët e SRD/GIZ zbatojnë për herë të parë në Shqipëri projektin e Fermave Edukative. Një iniciativë e realizuar në bashkëpunim me Qendrën për Edukim Kulinar, www.qek.al dhe falë konsulentëve të Agriplant Srl të Regione Puglia e cila ka nisur në qershor të vitit 2021 dhe përfundon në maj të vitit 2022.

Në këtë projekt kanë marrë pjesë ferma bujqësore, agroturistikë, ferma me potencial për të zhvilluar agroturizmin, fermerë të vegjël si edhe shkolla të hotelierisë e turizmit, nga rrethi i Shkodrës deri në rrethin e Sarandës. Së bashku kemi punuar në krijimin e disa paketave turistike që shkojnë përtej kulinariës dhe synojnë të nxisin aktivitetet edukative në ferma si:

Aktivitetet bujqësore; Aktivitetet blegtorale; Artizanat; Vreshtari; Peshkim; Përpunim të produkteve; Zahiret e më tej

Qëllimi i këtij koncepti është t'i kthejë fermat në vende rekreative dhe edukative për vizitorët, duke nxjerrë në pah karakteristikat e tyre. Ekspertët e angazhuar në projekt, sipas fushave të ndryshme që mbulojnë, janë kujdesur të ofrojnë asistencë dhe këshillimin e duhur. Ndër ta janë profesor Zef Gjeta, shefat e kuzhinës Sokol Prenga dhe Ar-

mand Kikino si edhe ekspertja ndërkombëtare për fermat edukative, Ida Boreli.

Deri më tani, përgjatë zhvillimit të projektit janë realizuar aktivitetet si:

Mbjelljet stinore; Rivitalizimi i farave të papërdorura prej kohësh, fara autoktone; Ndarja e përvijës në fushën e agronomisë; Nxitja e llojeve të kultivareve që u shërbejnë gatimeve tipike shqiptare; Gatimet shqiptare si pjesë e menuve; Vazhdimi i traditës së zahireve; Festimi i festave popullore në ferma; Hapja e pikave të vogla të shitjeve brenda agrotur-



izmeve e më shumë.

Një paketë e rëndësishme do të jetë edhe paketa për fëmijet e shkollave fillore me qëllim afrimin e tyre në fermë dhe pajisjen me dije që lidhen direkt me natyrën, të mbjellat, frutat,

lojërat në natyrë dhe ushqimin e shëndetshëm.

Gjithashtu nuk mungojnë trajnimet me nxënësit e shkollave profesionale të hotelierisë dhe ato bujqësore, si potencial për t'u punësuar në të ardhmen në këto ferma. Përmes projekteve të vogla, shkollat janë nxitur të njihen me fermat, agroturizmet, karakteristikat bujqësore dhe blegtorale, karakteristikat kulinare, bimët mjeksore dhe erëzat. 10 mësues dhe 75 nxënës kanë qenë pjesë e vazhdueshme e këtyre trajnimeve nën kujdesin e ekspertëve

znj. Mukades Memajdini dhe shefi i kuzhinës Sokol Prenga.

Në fund të projektit, paketat do t'u prezantohen edhe agjencive turistike me synimin që kjo iniciativë të promovohet edhe në nivel ndërkombëtar.

Kultivimi i sfungjerit - Inxhinieri që la naftën për bujqësinë

Rakip Belishaku, 28 vjeçari nga Kuci i Beratit, sapo përfundoi studimet në degën e inxhinierisë së naftës, nisi të punojë si inxhinier në vende të ndryshme të botës, Angli, Skoci dhe Izrael. Për disa vjet ai kërkonte puse naftë në det të hapur. Por dashuria për tokën e ktheu atë përsëri në fshat.

Rakip Belishaku: "Ajo që më mungoi më shumë në ato vite ishte toka, gjelbërimi dhe njerëzit"

Rakipi u kthye në shtëpi me ide të qarta, do të hiqte dorë inxhinieria për tu marrë me bujqësi. Si fillim ai shkuli rrënjët e domatëve që kishin mbjellë prindërit e tij dhe mbolli farat e sfungjerit natyral.

Rakip Belishaku: "Unë jam diplomuar si inxhinier naftë dhe për 7 vjet kam punuar për kompani të ndryshme ndërkombëtarisht. Dhe në 2019 këtë bimë e hasa për herë të parë e aeroportin e Vietnamit. Nuk e dija se çfarë ishte nga kuriezi-iteti e mora një të tillë dhe e solla në Shqipëri."

Ky vendimi i 28 vjeçarit nuk u mirëpritur nga familja dhe miqtë e tij, sepse sipas tyre në bujqësi derdh shumë djersë, dhe në fund të muajit të jep pak para.

Rakip Belishaku: "Familja ime është marrë historikisht

me bujqësi dhe ishte idea e tyre për të më gjetur një pro-

lufën një standard të tillë." Sfungjeri natyral që kultivo-



fesion që të largohesha nga fshati. Por njeriu bën atë që ndjehet më mirë dhe ka pasionet e tij. Ndoshta është më mirë të ndjekësh pasionet se sa një punë të sigurt."

Si inxhinier naftë, Rakipi arriti të fitonte afërsisht 5 mijë euro në muaj, por ai është i bindur që në të ardhmen bima e sfungjerit do t'i sjellë atij edhe më shumë të ardhura.

Rakip Belishaku: "Profesioni i inxhinierit të naftës është shumë i paguar jashtë. Puna ime e fundit arriti në nivelin e 200 eurove dita. Besoj se sëshpjeti do arrijmë të krijojmë me

het në Kuc të Beratit, brënda 2 vitesh arriti që të njihet edhe në Europë, eksportet e para kanë nisur me shtetin Gjerman.

Rakip Belishaku: "Ne provuam 4 varietetit të ndryshme të lufës deri sa arritëm të gjenim atë që i përshatet tokës këtu në Shqipëri. Doja të krijonim një brand made in albania dhe ta eksportonim."

Për Rakipin është më mirë të nxjerrësh nga toka sfungjer natyral, se sa arin e zi nga thellësia e detit.

Rakip Belishaku: "Mendoj se kjo është e ardhmja ime dhe do ta zhvilloj."

Draftligji "Për bletarinë", regjistrim edhe kur ke 1 koshere, masat mbështetëse dhe kontrolli

Qeveria ka prezantuar draftin final "Për bletarinë" duke synuar që për herë të parë të rregullojë këtë sektor me një ligj të veçantë. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nxori për konsultim këtë draft duke nënvizuar në relacionin që e shoqëron aspektet kryesore që do të mbulojë ligji.

Duke theksuar problematikën e dëmtimit që kanë pësuar bletët në disa raste në botë, rëndësinë e ruajtjes së pjesës autoktone, rritjes së prodhimit të produkteve që vijnë nga bletaria si dhe kontrollit më të shtuar të sektorit, ministria shton se kjo vjen e përafëruar edhe me kuadrin ligjor të Bashkimit Europian.

"Qëllimi i projektit është të njohë bletarinë si veprimtari me interes jetësor, kombëtar, e dobishme për ruajtjen e mjedisit natyror, ekosistemit dhe bujqësisë në përgjithësi dhe që synon garantimin e pjalmimit natyror dhe biodiversitetit të llojeve të bletëve, me referencë të veçantë për mbrojtjen e racës së bletës (Apis mellifera carnica) e popullata tipike vendase të bletëve ose zonave kufitare.

Objekti i këtij projekt akti është përcaktimi i rregullave për prodhimin, regjistrimin, transportin, riprodhimin, mbrojtjen, etiketimin, përpunimin dhe ruajtjen e produkteve të bletarisë, si dhe për kontrollin e cilësisë dhe gjurmueshmërinë e këtyre produkteve sipas programeve

3 vjeçare" thuhet në qëllimin e këtij projektakti.

Draftligji, çfarë sjell për sektorin

Draftligji "Për Bletarinë" vendos si kusht për të gjithë ata që kanë qoftë dhe një koshere bletësh që të regjistrohen pranë Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor brenda datës 30 prill të çdo viti.

Sipas draftit përcaktohet qartë se vendndodhja e parkut të bletëve nuk mund të jetë kudo por ato duhet të jenë të vendosura jo më pak se 10 (dhjetë) metra nga rrugët e tranzitit publik dhe jo më pak se 5 (pesë) metra nga kufijtë e pronës publike ose private.

Ky park mund të jetë i qëndrueshëm ose lëvizës.

Në çdo rast shtegtimi i bletëve nuk mund të bëhet pa dijeninë e autoriteteve. Për këtë duhet të kërkohet leje jo më pak se 6 ditë para datës së lëvizjes.

Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar me certifikatën veterinare për gjendjen shëndetësore të bletëve dhe raportin për masat e ndërmarra veterinare.

AKVMB, pasi merr mendimin e ekspertit në bashkëpunim me Shoqata Lokale të Bletëritësve, miraton apo refuzon vendosjen e parkut të bletëve.

Lidhur me llojin e bletës drafti parashikonte duhet të përdoret lloji i bletës Evropiane Apis Mellifera dhe nënlojet lokale të bletëve; Apis mellifera

carnica në vendet e Ballkanit, Apis mellifera ligustica, Apis mellifera sicula; Apis mellifera cecropia; Apis mellifera macedonica; Apis mellifera caucasica.

Sa i takon mbrojtjes së bletëve, bletari duhet të ketë njohuritë bazë mbi këtë sektor dhe duhet të marrë të gjithë masat për mbrojtjen e shëndetit të bletëve.

Draftligji sjell edhe pjesën Darftligji sjell edhe pjesën e etiketimit të produkteve të bletës dhe specifikimet që duhet të ketë ky proces.

Në nenin 22 ndalet në mbështetjen e sektorit të bletarisë duke nënvizuar nga promovimi dhe mbrojtja e produkteve shqiptare tek programet e kërkimit dhe eksperimentimit, stimujt për të rinjtë në bletari e deri tek mbështetja e bletarëve në zonat malore të pafavorizuara.

Në nenin 24 vendosen kushtet për ruajtjen e mjaltit dhe më pas dhe mbikëqyrja.

Ligji parashikon masa administrative kur aktiviteti ushtrohet në informalitet duke mos e raportuar atë, kur nuk zotërohet certifikatë e gjendjes shëndetësore të bletëve apo kur nuk njoftohen inspektorët kur ka dyshime për sëmundje me karakter përhapës.

Ligji do të ketë nevojë për akte nënligjore të miratuara më pas ndërkohë që shtrirja e efekteve do të jetë dy vite pas hyrjes në fuqi.

KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS"



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI Ndërmjet

SHOQËRISË KURSIM KREDI "FED invest" & KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"

Më 7 prill 2022, me rastin e Ditës së Financës Sociale, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi midis SHKK "FED invest" & KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS".

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi dhe partneriteti dypalësh në kuadër të zhvillimit dhe transmetimit të dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve nga institucionet e arsimit të lartë.

Bashkëpunimi do përfshijë përmirësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së programeve të studimit përmes bashkërendimit të përmbajtjes teorike me aspektet praktike për një përgatitje sa më cilësore dhe profesionale të studentëve në fushën ekonomike e financiare në përgjithësi dhe fushën e bujqësisë, agrobiznesit, agropërpunimit dhe financave rurale specifikuat.

Kjo marrëveshje synon shfrytëzimin sa më të mirë të informacionit shkencor, infrastrukturës funksionale dhe potencialit intelektual të të dy institucioneve.

Fushëveprimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit do të ketë në fokus

- Promovimin e të reja me të fundit në sektorin e bujqësisë, blegtorisë, zhvillimit rural, agropërpunimit, agroturizmit, financat rurale dhe TIK në sistemin e AGB nëpërmjet:

- Organizimin e konkursit vjetor të FED invest /Qendrës ABA për stafin studentor dhe akademik të Kolegjit Universitar "LOGOS" në lidhje me përgatitjen e punimeve/miniprojekteve, publikimin e artikujve, studimeve dhe punimeve të studentëve dhe stafit akademik në platformën e FED invest (www.abaonline.al)

- Kryerjen e studimeve të përbashkëta për tregun e prodhimeve bujqësore, menaxhimin e fermave bujqësore, menaxhimin financiar etj.

- Ofrimin e mundësive për studentët e Kolegjit Universitar "LOGOS" për të zhvilluar praktikën mësimore pranë FED invest.

- Mundësinë për të patur një udhëheqës pranë institucionit në ditët e praktikës me qëllim të zbatimit të programit të tyre.

- Potencialisht, pas procesit të vlerësimit, mundësinë e rekrutimit të studentëve nga FED invest nëpërmjet

jet programeve të zhvilluara për promovimin e talentëve.

Në kuadër të njohjes së studentëve të Kolegjit Universitar "LOGOS" me qëllimin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje në sallën e amfiteatrit të madh, u realizua edhe një leksion i hapur me temë: "FED invest, Histori Suksesit e Financës Sociale".

Z. Perlat Sulaj (Administrator i FED invest) dhe Z. Behar Gjoni (zv. Administrator i FED invest) realizuan një përmbledhje shumë interesante për studentët lidhur me këtë bashkëpunim dhe përftimet që do të kenë studentët nga kjo marrëveshje.

Rreth SHKK "FED invest",

përfaqësuar nga Z. Perlat Sulaj, Administrator

Përfaqëson një prej institucioneve të para të tregut financiar në vend, misioni i së cilës është të ofrojë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare, veçanërisht për popullsinë që jeton në zonat rurale të Shqipërisë, me qëllim rritjen e përfshirjes financiare dhe reduktimin e përgjithshëm të varfërisë. FED invest është një model i suksesshëm kooperimi për fermerët dhe të gjithë sipërmarrësit e vegjël shqiptarë prej gati 30 vitesh, në pronësi të tyre dhe aktualisht ka rreth 82 mijë anëtarë të cilët shërbehen nga një staf i kualifikuar dhe me një rrjet prej 62 degëve në të gjithë Shqipërinë, në zonat urbane dhe rurale. FED invest përfaqëson kooperativën më të madhe financiare në vend, pas së cilës qëndrojnë një numër i madh historik suksesit të anëtarëve të saj, fermerë dhe sipërmarrës të vegjël, që kanë ngritur dhe zhvilluar aktivitetin e tyre, nga një nivel mikro, në aktivitete dhe biznese të qëndrueshme. Për më shumë vizitoni websitin www.fedinvest.al

Rreth Kolegjit Universitar "LOGOS"

- Kolegji Universitar "LOGOS" është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1055, datë 29.7.2009.

- **Vizioni**

- Kolegji Universitar "LOGOS"

SHOQËRIA KURSIM KREDI "FED invest"



synon të jetë një qendër moderne e të mësuarit dhe kulturës për transformimin e jetëve.

• Misioni

• Misioni i Kolegjit Universitar "LOGOS" është t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimimit, kërkimit shkencor, inovacioneve; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve; garantimit të suksesit të studentëve në një mjedis global; ofrimit të shërbimeve akademike dhe zhvillimit të një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës. Kolegji Universitar "LOGOS" ofron programe studimi në fushën e Shkencave të Aplikuara, Ekonomisë dhe Shkencave Humane e Komunikimit Gjuhësor. Programet e Kolegjit Universitar "LOGOS" synojnë të përgatisin specialistë në fushat, si: të shëndetit, të ekonomisë, të arsimit, të mirëqenies sociale, të teknologjisë së informacionit, të theologjisë, të komunikimit, të bujqësisë.

• Kolegji Universitar "LOGOS" ka dy kampuse, njëri i vendosur në një ndërtesë moderne në hyrje të qendrës së Tiranës, pranë Tirana Ring Center dhe tjetri në Shën Vlash, Durrës. Në të dy kampuset ka mjedise funksionale mësimi, laboratorë për analiza mjekësore, laboratorë informatike, atelie për arsimin parashkollor, software financiarë, që mundësojnë të mësuarit praktik; biblioteka që krijojnë mundësi për kërkimin shkencor, palestër moderne për të qenë gjithmonë aktiv. Për më shumë vizitoni websitin <http://www.kulogos.edu.al/al/index.html>



(Vijon nga faqja 3)

lidhur ngusht dhe kondicionohet jo pak veçanërisht për punësimin gjithëvjetor dhe rritjen e të ardhurave edhe nga situata e pyjeve, livadheve, kullotave, agropylltarisë dhe ajo e mjedisit në zonat rurale.

Zonat e mbrojtura në Shqipëri shërbejnë si një model dobiprurës për zhvillimin e pyjeve, livadheve, kullotave por edhe mjedisit. Gjithashtu këto zona vlerësohen për rëndësinë dhe potencialet e papërdorura që kanë për zhvillimin e agroturizmit, bletarisë, prodhimin e bimëve mjekësore e aromatike, të frutave të pyllit, për sporte të veçanta në natyrë dhe gjuetinë rekreative. Ato shtrihen në të gjithë territorin dhe zënë në një sipërfaqe toke të konsiderueshme prej 523831 ha.

Flora dhe fauna e tyre është mjaft e pasur dhe e shumëllojshme, në të cilat rriten rreth 3221 lloje të ndryshme bimësh.

Gjithashtu rriten në mënyrë natyrale e kultivohen rreth 330 specie bime mjekësore dhe aromatiko-vajore dhe prodhohet edhe një gamë e gjerë fruta pylli natyrale.

Fauna gjithashtu është shumë e pasur, në të cilat pasur një moratoriumi kombtar disa vjeçar, aktualisht po shtohen në sasi e rritet një shumëllojshmëri shpendësh e kafshë të egra si Ariu Murrem, Ujku, Kunadhja, Dhelpra, Çakalli, Dhia e Egër, Derri Egër, Kaprolli, dy lloje Macesh të Egra, Rreqebulli e Vjedulla, 14 lloje Lakuriqe nate dhe rreth 350 lloje zogj vendas, dy lloje të rralla të Gjelit të Eger dhe Qukapikut. Gjithashtu edhe disa lloje zogjsh grabitqar si Shqiponjat, Fajkonjtë, Hutat, Skifterët, disa lloje bufi si Bufi me Mjekër, Bufi me Bri dhe Kukuvojka e vogël.

Zona rurale në Shqipëri në dallim edhe nga shumë vende të zhvilluara vazhdon akoma të jetë shumë e populluar. Banorët kanë bërë investime të konsiderueshme në banesa të reja dhe procesi në shumë zona po vijon me rikonstruksionin e atyre ekzistuese. Aktualisht në këto zona në mbi 2500 fshatra banojnë akoma rreth 38 % e popullsisë së vendit. Qeveria shqiptare ka përzgjedhur si pikënisje për të mbështetur me prioritet investimet në 100 fshatra në të 61 bashkitë e vendit, me synim krijimin e një modeli zhvillimi, për t'u përhapur në gjithë territorin e zonave rurale, për ti paraprirë zhvillimit të turizmit rural, si dhe përdorimit me efikasitet të të gjitha resurseve që Shqipëria disponon. Mbulimi me telefoni mobile dhe internet, me energji elektrike, me rrjet rrugor primar është i shtrirë dhe vazhdon

procesi pothuaj në të gjitha zonat rurale produktive ku gjenden resurset e mësipërme, për të mundësuar e realizuar investime sa më efçente.

Turizmi Rural, Agropylltaria dhe Mjedisit në Zonat Rurale:

Shqipëria ofron një potencial të madh për zhvillimin e turizmit rural dhe të agroturizmit në veçanti. Ndërsa ky sektor është shfaqur të zhvillohet vetëm gjatë viteve të fundit, pritet që ai të rritet shpejt në të ardhmen e afërt dhe të mesme.

Konceptet e turizmit rural dhe agroturizmi si pjesë e tij shpeshherë ngatërrohen nga fermat dhe subjektet e agrobiznesit, madje ndonjëherë edhe në nivel institucional, veçanërisht tani që agroturizmi po trajtohet si sektor i veçantë dhe aktivitet agrobiznesi fitimprures.

Agroturizmi është një aktivitet pritës, që zhvillohet në fermë ose në njësi të tjera bujqësore me qëllim tërheqjen e vizitorëve, shpesh duke u mundësuar edhe pjesëmarrjen në aktivitete bujqësore ose aktivitete të tjera ndihmëse që zhvillohen në mjedisin bujqësor. Çdo formë e turizmit që tregon jetën rurale, artin, kulturën dhe trashëgiminë në vendet rurale, që i sjell komunitetit vendas përfitime ekonomike dhe sociale, si dhe që mundëson ndërveprimin midis turistëve dhe banorëve vendas për një përvojë më të pasur turistike, mund të përkufizohet si **turizëm rural**.

Për ta përmbledhur, agroturizmi është një nëndegë e turizmit rural, me një koncept më të gjerë që e mund të përfshijë pothuajse çdo veprimtari turistike që zhvillohet në zonat rurale.

Potenciali i pashfrytëzuar

për zhvillimin e agroturizmit ekziston pothuajse në të gjithë vendin. Qarqet që premtojnë më shumë në ndërthurjen e bujqësisë me atraksionet turistike janë Korça, Berati, Gjirokastra, Vlora, Shkodra, Kukësi dhe Dibra. Modelet më të zakonshme të agroturizmit janë restorantet "nga ferma në tryezë" me kapacitete të kufizuara akomodimi. Agroturizmi trajtohet si një **sektor me prioritet të lartë** në programin e qeverisë. Shumica e strategjive të nivelit qendror dhe vendor e kanë konsideruar agroturizmin të rëndësishëm për bujqësinë dhe diversifikimin rural. Sektori po përfiton nga disa **stimuj fiskale** që përfshijnë reduktim të tvsh-së në 6%, tatim mbi të ardhurat e shoqërisë në 5% dhe përjashtim nga taksa e infrastrukturës për investimet. Programi "100 fshatrat" dhe programe të tjera mbështetëse, në buxhetin afatmesëm parashikohet të injektohet një vlerë prej **50-70 milionë euro** investime të reja

(Vijon në faqen 7)

(Vijon nga faqja 6)

në sektor. Gjithashtu nga vrojtimet që kemi bërë pritet të rrisë ofertën me 27 njësi të reja të agroturizmit dhe rreth 150 bujtina. Në secilin qark ka rreth 500 ferma të regjistruara që përshtaten me karakteristikat e agroturizmit dhe rreth 20% e tyre janë të gatshme të fillojnë një biznes agroturizmi. Ekzistenca e 12 qarqeve do të thotë 1200 sipërmarrje potenciale agroturizmi që presin mundësi investimi gjatë 5 deri në 7 vitet e ardhshme. Kriteret minimale që duhen përmbushur në mënyrë që një njësi të klasifikohet si si njësi agroturizmi. Kriteret lidhen me sipërfaqen minimale të tokës bujqësore, kapacitetet akomoduese dhe shërbime të ushqimit, burimet e produkteve etj. Më konkretisht, kriteret kryesore janë:

- Toka - 1 ha në terren të hapur ose 0,5 ha në zona të mbrojtura;

- Shërbimet - Njësitë e agroturizmit duhet të ofrojnë një nga shërbimet e mëposhtme: ushqim, akomodim, shërbime rekreative;

- Kapacitetet e akomodimit: - 6 deri 30 dhoma akomodimi.

- Arkitektura e ndërtesave: Në përputhje me VKM-te nr. 711 dhe 730 për "Kushtet, kriteret dhe procedurat për klasifikimin e strukturave akomoduese".

- Restorantet - nga 6 deri në 60 tavolina për shërbimin e ushqimit;

- Origjina e produkteve - të paktën 30% e ushqimeve dhe pijeve që ofrohen në njësitë e agroturizmit duhet të jenë prodhime të fermës, pjesa tjetër prej 70% mund të blihet nga fermat e tjera përreth. Pra, agroturizmi nuk mund të shihet si i ndarë nga veprimtaritë bujqësore.

- Siguri ushqimore e garantuar, uji i pastër, produkte natyrale të prodhuara në ambiente të certifikuar, përdorim i mirëkontrolluar i plehrave kimike, pesticideve dhe insekticideve. (**Shih tabelën nr. 6 dhe 7, faqe 9).**

Agropylltaria dhe Mjedisit në zonat rurale:

Agropylltaria është një praktikë pak e dëgjuar dhe e zhvilluar, por ajo ofron potenciale e mundësi të mira përfitimi për fermerët në Shqipëri. Ajo shërben si habitat për botën e egër shtazore, për rritjen e cilësisë së ujit dhe ajrit, duke ndikuar pozitivisht në përmirësimin e mikroklimës së zonës, rrit të ardhurat e diversifikuar të fermës, përmirëson shëndetin në komunitetet rurale, ndikon në rritjen e rendimentit dhe prodhimin bimor nga 7-35%, rrit numrin e produkteve dhe të ardhurave nga ferma, përmirëson cilësinë e tokës dhe redukon erozionin, redukon imputet që përdoren për menaxhimin e dëmtuesve, humusi pyllit shërben si një burim i rëndësishëm dhe lëndë e parë për prodhimin e plehurove organik ekologjik.

Përmirësimi mjedisi në zonat rurale në Shqipëri ka tërhequr vëmendjen e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar

(KASH), shoqatave të prodhuesve të produkteve organike, për të marrë disa masa pa humbur më shumë kohë, për mirëmenazhimin e mbetjeve organike, riciklimi i tyre dhe përdorimin për prodhimin e plehurove organik të pastër, që është një mundësi e mirë për investime në këtë fushë. Sipas një studimi që është bërë nga ekspertët të fushës rezultojnë se në Shqipëri dekompozohen në natyrë pa u përpunuar rreth 1 milion ton/vit mbetje organike. Vlerësohet se një pjesë e mirë e tyre mund të përdoret si lëndë e parë për prodhimin e plehurove organik ekologjik. Aktualisht me dhjetëra mijë ton/vit pleh organik importohen nga subjektet shqiptare. Prodhime organike pa prodhuar pleh organik të pastër nuk mund të kemi.

Pyetje që shtrohen dhe kërkohen përgjigje: Çfarë masash duhen marrë për rivlerësimin e agropylltarisë në Shqipëri?

Çfarë e pengon prodhimin e plehurove organik të pastër në Shqipëri?

A duhet hartuar një strategji e veçantë për përpunimin e mbetjeve organike në zonat rurale?

Sa është kapaciteti dhe mundësia për të prodhuar pleh organik të pastër dhe sa janë nevojat e vendit?

A mundet Shqipëria të prodhojë pleh organik të pastër edhe për eksport?

Sa efçente është dhe sa e dëmton mjedisin dhe tokën bujqësore përdorimi i plehurove organik të freskët dhe të papërpunuar?

A duhet mbështetur inisiativa e propozuar nga KASH për të zbatuar një Projekt pilot me fokus Agrobiznesin Mjedisin dhe Turizmin Rural.

A është menduar çfarë do të bëhet me mbetjet e thata, që rezultojnë nga përpunimi ujërave të zeza urbane dhe për përpunimin e mëtejshëm e përdorimin e tyre si pleh për lule dhe bimë dekorative?

Objekt i një diskutimi të veçantë në këtë "Tryezë tematike" të radhës është programuar të jenë:

I. Procesi i Kooperimit dhe Koordinimit institucional, jo vetëm brenda hallkave të sektorit bujqësisë, por edhe me sektorët e tjera të Ekonomisë së Ushqimit, konkretisht atë të "Blegtorisë", "Peshkimit dhe Akuakulturës", "Agrobiznesit", "Agropërpunimit", "Bimëve Mjekësore, Aromatike dhe Bletarisë", "Agroturizmit, Agropylltarisë dhe Mjedisit në zonat rurale", "Tregjeve Agro - Blegtorale", "Financës, Mikrofinancës dhe përmirësimin të legjislacionit që impakton zonat rurale.

II. Fusha e Mekanizimit, Inovacionit dhe Dixhitalizimit
III. Fusha e Financës,

Mikrofinancës, Disbursimi të fondeve grant

IV. Fusha e Përmirësimin të Legjislacionit dhe Përfarimit me atë të BE

I. Procesi të kooperimit dhe koordinimit institucional në bujqësi:

KASH ka arritur në konkluzion se këtij procesi jo vetëm që i ka ardhur koha, por ka kaluar shumë kohë, për ta konsideruar si një pengesë kryesore, për arritjen e objektivave që janë miratuar, por edhe si një faktor me rëndësi të veçantë për dobinë e tij, si për fermerët dhe subjektet e tjera, ashtu edhe për mirëqeverisjen.

Përvoja jonë pozitive dhe e vendeve me bujqësi të zhvilluar na ka provuar se: Përmes zhvillimit dhe konsolidimit të këtij procesi, mund të përmirësohet situata e informalitetit në prodhimin e tregtisë, mund të rritet efçenca në mekanizim, inovacionin e dixhitalizim, mund të lehtësohet veprimtaria e financimit dhe disbursimit të fondeve grant duke rritur të ardhurat. Gjithashtu edhe për KASH dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile, mbrojtja e interesave dhe veprimtaria për përmirësimin të legjislacionit do të jenë më efçente dhe procesi i integritimit rajonal dhe ai Europian do të jetë edhe më dobipërrës për Shqipërinë.

Sektor bujqësisë efçent e dobipërrës për fermerët, për ekonominë e vendit dhe konkurren në rajon, nuk mund të konsiderohet kur edhe mbas 30 vitesh në Shqipëri rezultojnë 80 % bujq të pavarur ose fermerë, që zhvillojnë veprimtari individuale informale dhe 20 % ferma apo subjekte të tjera të formalizuara.

Sektor i bujqësisë në Shqipëri, veçanërisht për sa i përket administrimit të tokës, si një ndër faktorët kryesor të prodhimit ka disa specifika krahasuar me çdo sektor bujqësisë në vendet e rajonit dhe më gjerë.

- Katërqind e njëzet mijë familje fermere që banonin dhe punonin në zonat rurale deri në vitin 1991 përfituan tokë bujqësore/banor falas me ligjin 7501 "Për Tokën", si dhe disa asetet e tjera. Ligji 7501 "Për Tokën" është specifik vetëm për Shqipërinë dhe nuk kemi gjetur asnjë eksperiencë tjetër në rajon por edhe më gjerë ku toka të ndahej në atë mënyrë si u nda në Shqipëri.

- Shpërndarja e sipërfaqes së tokës falas nuk u programua dhe nuk u zbatua në përputhje me parimin e nevojave/banor në shkallë vendi, por u programua dhe realizua bazuar në sipërfaqet/banor sipas ndarjeve administrative të asaj periudhe.

- Mënyra e shpërndarjes së tokës bujqësore bazuar në ndarjet administrative krijoi pabarazi, disa zona përfituan më shumë tokë/banor sesa nevojat për konsumin vetiak

dhe blegtorisë së tyre, disa të tjerë përfituan më pak, disa nuk e pranuan dhe e kanë braktisur tokën.

- Sipërfaqja e tokës bujqësore prej 699 mijë ha, jo vetëm që u nda pa marrë parasysh kriteret bazë të efçencës për përdorimin e saj për 420 mijë familje, por edhe u legalizua copëzimi jashtë çdo kriteri ekonomik në 1.8 milion parcela. Proces copëzimi që po vazhdon akoma sepse familjet ndahen edhe toka vazhdon pa asnjë pengesë të copëzohet.

- Procesi i dhënies së certifikatave të pronësisë eci ngadalë dhe tregu i shitblerjes së tokës bujqësore në Shqipëri nuk ka funksionuar dhe vazhdon të jetë tejet i limituar.

- Treqind e pesëdhjetë e katër mijë familje nga 420 mijë që përfituan tokë bujqësore falas u regjistruan si fermerë individualë, si bujq të pavarur. Të cilët në funksion të sipërfaqes dhe përdorimit të tokës, praktikisht mund t'i klasifikojmë në tre grupime, sepse në fakt kështu janë të ndarë.

Grupi i parë, të cilët mund t'i quajmë si bujq të pavarur, po e përdorin tokën për të plotësuar vetëm nevojat e veta dhe të blegtorisë së tyre, duke lënë sipërfaqe të konsiderueshme toke produktive, që kanë në pronësi apo në përdorim, pa e kultivuar dhe pa e përdorur. Pasoja negative të lënies për shumë vite djerrë të tokës bujqësore produktive dihen sa shumë dëme sjellin për individin dhe shoqërinë.

Grupi i dytë, që mund t'i quajmë si fermerë individualë. Të cilët në përgjithësi e përdorin dhe kultivojnë të gjithë sipërfaqen e tokës, që kanë në përdorim apo në pronësi. Atyre u mbetet edhe një teprice produktesh për shitje, që mund të shkojë kryesisht për plotësimin të nevojave të tregut të vendit. Por ky grupim duke vepruar në mënyrë informale has në vështirësi të mëdha për gjetjen e tregjeve, ka një kosto të lartë dhe skarcitet të madh të prodhimit, ka prodhime cilësore, por të paambulazhuara dhe të pacertifikuar, nuk përfiton lehtësi fiskale e mbështetje financiare falas, dhe ka një tendencë në rritje për ta lënë tokën djerrë e të largohet nga zonat rurale, për në emigracion ose në zonat urbane.

Grupi i tretë, që përbën rreth 20 % të fermerëve janë të formalizuar, kanë në pronësi dhe përdorim sipërfaqe të mëdha toke, kanë investuar për mekanikën bujqësore, për sisteme ujëtieje efçente, kanë marrëveshje bashkëpunimi midis tyre dhe me qendrat e grumbullimit, përfitojnë direkt nga subvencionet dhe lehtësitë fiskale, kanë investuar dhe janë në proces të pandërprerë investimesh në bujqësi dhe në të gjitha hallkat e zinxhirit ush-

qimor. Ky grupim e ka orientuar aktivitetin për të prodhuar produkte për tregun vendas dhe për eksport. Ata janë më të avantazhuar dhe po shërbejnë si model zhvillimi për dy grupimet e para.

Veprimtaria e bujqve të pavarur të grupit të parë dhe fermerëve individualë të grupit të dytë në Shqipëri shoqërohet me shumë probleme.

Grupi i parë dhe i dytë për disa arsye, shumica e të cilave janë subjektive, kanë lënë djerrë sipërfaqe të konsiderueshme toke bujqësore produktive, e cila sipas sondazheve të KASH vlerësohet rreth 100 mijë ha tokë të papunuar e pa kultivuar me bimë në vite.

Toka në fushë është mjaft produktive, e pakontaminuar, e mundshme për t'u ujitur dhe punuar me mekanikë bujqësore. Gjithashtu sipërfaqe të konsiderueshme toke, që janë lënë djerrë veçanërisht në kodra, janë konsideruar të përshtatshme, për rritjen e pemëve frutoreve, ullinjve, vreshtave, agrumeve, arrorëve, bimëve mjekësore dhe aromatike etj.

Sipërfaqe të mëdha pyjesh, kullotash dhe livadhesh të përshtatshme për mbarshkrimin e blegtorisë, shpendëve, rritjen e bimëve mjekësore e aromatike, bletarisë, zhvillimin e agropylltarisë, frutave të pyllit nuk po u kushtohet vëmendje dhe nuk po përdoren me efçencë. Kjo sipërfaqe toke e lënë djerrë, pa investime, jashtë vëmendjes, mund të përdoren në masë të madhe edhe për të mbështetur zhvillimin e turizmit rural e në veçanti të agroturizmin. Gjithashtu dhe për të rritur sasinë e prodhimeve natyrale e organike në vend.

Sipërfaqe më të mëdha të tokës djerrë apo të pakultivuara periodikisht i përkasin kryesisht shtetit dhe grupimit të parë e të dytë të fermerëve, veçanërisht ajo kategori përfituesish që e kanë përfituar tokën me ligjin 7501, por që nuk kanë pranuar ta marrin atë në dorëzim në zbatim të ligjit 7501 "Për tokën". Gjithashtu duhet diskutuar e rivlerësuar edhe qëndrimi indiferent i deritanishëm që po mbahet nga institucionet publike ndaj grupit të parë të bujqve të pavarur dhe grupit të dytë të fermerëve individual, të cilët edhe për shkak të ligjit 7501 "Për Tokën" posedojnë apo kanë në pronësi rreth 80 % të tokës bujqësore. Të dy grupet e bujqve dhe fermerëve janë shumë të rëndësishëm sepse janë faktori kryesor vendimarrës për zgjidhjen e problemit të përdorimit të tokës. Ato janë dy grupimet që në finale vendosin për përdorimin me efçencë ose jo të tokës bujqësore në Shqipëri.

Efçenca e përdorimit të tokës dhe në veçanti e tokës bujqësore duhet konsideruar dhe ligjëruar, jo vetëm si çështje e thjeshtë personale e pronarit apo poseduesit të saj, por edhe si një çështje me rëndësi për sigurinë

ushqimore dhe në raste krizash edhe për sigurinë kombëtare, e cila për situatën dhe sipërfaqen e tokës bujqësore/banor që ka Shqipëria duhet të prevalojë mbi të parën.

Pyetjet që shtrohen dhe që duan përgjigje:

Pse nuk vlerësohet procesi i kooperimit nga bujqit e pavarur të grupit të parë dhe fermerët individualë të grupit të dytë, kur është provuar që kooperimi ka rezultuar dobipërrës si në Shqipëri dhe në vendet me bujqësi të zhvilluar?

Çfarë pengesash kanë patur dhe kanë aktualisht në Shqipëri, organizimi bujqëve të pavarur dhe fermerëve individual në 104 Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB), si dhe rreth 42 mijë fermerëve të organizuar në klastera informale me qendrat e grumbullimit? Si mundet të kapërcehen këto pengesa?

Çfarë duhet bërë më shumë për të përmirësuar situatën në procesin e kooperimit nga përfaqësuesit e bujqëve të pavarur, të fermerëve individualë, nga KASH dhe shoqatat e agrobiznesit, nga institucionet e arësimit të lartë, nga qeveria dhe donatorët?

Pse politikëbërësit nga të gjithë krahët, për një kohë shumë të gjatë po qëndrojnë indiferent, vetem sa konstatojnë që procesi i kooperimit ka rëndësi, por mjaftohen vetëm me thirrje drejtuar bujqëve të pavarur dhe fermerëve individualë që të bashkohen, sepse kështu të vetmuar nuk mundet dhe nuk do t'i përkrahin, për t'ua lehtësuar veprimtarinë e tyre ekonomike?

A duhet pritur akoma edhe mbas 30 vitesh të vazhdohet me këtë qëndrim në pritje, apo të një loje ping pongu pa fund, për procesin e kooperimit si nga sektori privat dhe ai publik?

A duhet që në strategjinë e zhvillimit të bujqësisë 2021 – 2027, që është në proces e pritet të miratohet së shpejti, të studiohet, analizohet e trajtohet më seriozisht, për t'i dhënë zgjidhje pa humbur më shumë kohë problemit të kooperimit dhe koordinimit institucional në sektorin e bujqësisë dhe hallkave kryesore të fushës së Ekonomisë Ushqimit në Shqipëri?

Përgjigjet e pyetjeve dhe zgjidhjet që do të sugjerohen nga pjesëtarët e "Tavolinës tematike" do të na orientojnë e ndihmojnë shumë në procesin e përgatitjes, orientimit dhe efçencën e zhvillimit të Forumit për bujqësinë, Turizmin Rural dhe Mjedisin. Gjithashtu edhe për formulimin e rezolutës, si dhe të një programi me masa konkrete, për ta futur në rrugën e zgjidhjes këtë proces kaq dobipërrës.

Procesi kooperimit dhe koordinimit institucional ka rëndësi jo vetëm për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, turizmit rural dhe mjedisit, por është i lidhur ngushtë dhe ka ndikim edhe në ruajtjen e stabilitetit të Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri, por edhe përmirësimin e situatës në disa

(Vijon në faqen 10)

BUJQËSI - MJEDIS

Çështje për diskutim në Tryezën Tematike: “Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisi në zonat rurale në Shqipëri”

Tab. Nr. 1. Struktura e mbjelljeve e bimëve të arave vitet 2005 -2020 sip në 000/ha

Nr / No	Emërtimi	2005	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Description
1	Drithra	147.7	145.7	147.7	143.0	142.1	143.2	142.6	148.0	145.7	140.1	132.2	131.3	Cereals
	Grurë	82.4	73.9	69.2	73.2	71.2	70.0	69.6	70.5	68.1	65.1	57.3	53.9	Wheat
	Misër	48.4	54.2	61.2	53.5	53.5	55.0	54.6	58.5	58.1	54.1	55.1	56.7	Maize
	Thekër	1.5	1.1	1.5	1.3	1.2	1.4	1.3	1.2	1.2	1.0	1.2	1.3	Rye
	Elb	1.5	2.5	2.8	2.4	2.5	2.7	2.5	3.1	3.1	3.4	2.7	3.8	Barley
	Tagjira	13.9	14.0	12.9	12.5	13.6	14.1	14.6	14.7	15.4	16.6	15.8	15.5	Oats
2	Perime & bostanore*	32.5	30.8	30.6	31.0	30.0	30.0	31.1	31.2	31.9	31.7	33.0	33.5	Vegetable & melons*
3	Luleshtrydhe									0.1	0.1	0.1	0.1	Strawberries
4	Patate	10.1	9.0	9.5	9.3	9.1	9.6	10.1	9.7	9.9	9.7	10.2	9.7	Potatoes
5	Fasule	16.1	13.7	14.4	14.6	14.2	14.6	14.9	13.7	13.0	13.4	13.5	13.3	White beans
6	Duhan	1.5	1.2	1.2	1.3	1.7	1.5	1.2	1.1	0.9	1.0	0.8	0.8	Tabacco
7	Lule dielli	1.1	1.3	1.5	1.4	0.8	0.7	0.7	0.7	0.5	0.4	0.4	0.5	Sunflower
8	Sojë	0.4	0.3	0.3	0.3	0.2	0.2	0.2	0.3	0.2	0.3	0.2	0.2	Soybean
9	Panxharsheqeri									0.7	0.7	0.8	0.8	Sugarbeet
10	Bime Medicinale erza						5.0	5.0	5.0	5.4	5.6	5.6	6.3	Medicinal plant
11	Foragjere të njoma	191.0	202.0	204.0	208.9	215.3	204.2	207.3	208.6	215.7	217.4	220.1	225.0	Forage
	Sipërfaqja e mbjellë	400.4	404	409	409.839	413.3	408.9	413.1	418.3	424.2	420.3	417.0	421.6	Sown area

Tab. Nr.2 Prodhimi i bimeve të arave, 2014-2020

Prodhimi i bimëve të arave, 2014-2020									
Field crop production, 2014-2020									
Nr/ No	Emërtimi	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Description
1	Drithra	700.4	695.5	698.4	701.7	678.2	666.1	684.0	Cereals
	Grurë	280.0	275.0	275.0	274.9	240.3	233.2	233.4	Wheat
	Misër	380.0	380.0	379.7	381.1	391.1	389.0	399.1	Maize
	Thekër	3.1	3.0	2.7	2.7	2.3	2.6	3.2	Rye
	Elb	7.3	7.0	9.0	9.0	9.7	7.9	12.6	Barley
	Tagjira	30.0	30.5	32.0	34.1	34.9	33.4	35.6	Oats
2	Perime	950.0	1,030.0	1,129.0	1,152.0	1,166.3	1,258.0	1,295.7	Vegetables
3	Luleshtrydhe	-	-	-	5.1	4.4	5.3	5.4	Strawberries
4	Patate	240.0	245.0	238.3	249.8	254.5	260.7	254.9	Potatoes
5	Fasule	30.0	28.0	24.8	21.2	24.5	24.8	25.8	White beans
6	Duhan	3.0	2.2	1.8	1.4	1.7	1.4	1.4	Tobacco
7	Lule dielli	2.0	2.0	2.0	1.1	0.8	1.0	1.3	Sunflower
8	Sojë	0.4	0.5	0.7	0.5	0.7	0.6	0.4	Soybean
9	Panxharsheqeri	-	-	-	29.7	27.5	30.7	27.0	Sugarbeet
10	Bimë medicinale	17.4	10.8	10.6	12.8	12.5	12.9	14.4	Medicinal crops
11	Foragjere	6,100.0	6,000.0	6,144.0	6,688.6	7,050.1	7,115.2	7,170.6	Forage

Tab. Nr.3 Sipërfaqja e kultivuar me perime gjithsej, 2013-2020

Sipërfaqja e kultivuar me perime gjithsej, 2013-2020*									
Cultivated area with total vegetables, 2013-2020*									
Nr/No	Qarku / Prefecture	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1	Berat	2,316	2,406	2,481	2,689	2,789	2,824	2,969	3,098
2	Dibër	1,670	1,835	1,506	1,584	1,626	1,660	1,699	1,944
3	Durrës	3,782	3,666	3,713	3,590	3,673	3,763	3,710	3,731
4	Elbasan	2,955	2,917	2,998	3,176	3,020	3,057	3,035	3,198
5	Fier	8,443	8,452	8,636	9,310	9,152	9,298	10,481	10,936
6	Gjirokastrë	888	916	942	918	900	1,095	1,154	1,136
7	Korçë	2,507	2,622	2,853	2,859	2,980	3,026	3,105	3,148
8	Kukës	706	685	662	697	674	705	747	757
9	Lezhë	2,000	1,444	1,755	1,920	2,111	2,044	2,057	2,084
10	Shkodër	3,958	3,904	3,773	3,949	4,242	3,754	3,771	3,737
11	Tiranë	5,590	5,785	5,907	6,047	6,081	6,053	6,148	6,253
12	Vlorë	1,957	1,937	1,942	2,062	2,177	2,189	2,564	2,652
	Shqipëri	36,771	36,568	37,168	38,803	39,423	39,468	41,440	42,673

* Sipërfaqja e kultivuar me perime gjithsej përfshin perime të para dhe të dyta.

Tabela nr.4 Prodhimi i perimeve gjithsej, 2013-2020

Prodhimi i Perimeve gjithsej, 2013-2020									
Production of total vegetables, 2013-2020									
Nr/No	Qarku / Prefecture	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1	Berat	85,634	90,638	105,641	120,895	121,433	118,687	126,555	131,735
2	Dibër	52,559	54,881	46,759	50,209	44,774	47,689	44,936	52,584
3	Durrës	89,656	91,955	95,260	96,928	91,224	94,544	99,221	99,896
4	Elbasan	80,169	75,261	78,683	93,015	83,949	88,216	91,806	98,176
5	Fier	275,128	294,920	326,663	369,503	405,928	418,921	484,366	506,531
6	Gjirokastrë	14,119	14,230	17,294	13,713	14,098	14,495	14,810	14,851
7	Korçë	62,273	68,921	78,663	81,671	85,254	81,637	82,028	76,472
8	Kukës	14,099	14,174	13,477	14,171	14,452	13,027	13,383	14,946
9	Lezhë	43,942	32,922	39,717	45,269	43,361	43,013	48,133	47,128
10	Shkodër	75,098	75,499	76,530	82,389	84,963	80,421	80,376	78,131
11	Tiranë	100,222	104,726	115,974	123,661	124,148	127,176	128,666	130,001
12	Vlorë	31,100	31,873	35,339	37,676	38,344	38,457	43,731	45,275
	Shqipëri	924,000	950,000	1,030,000	1,129,101	1,151,928	1,166,283	1,258,012	1,295,726

BUJQËSI - MJEDIS

Çështje për diskutim në Tryezën Tematike: “Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisi në zonat rurale në Shqipëri”

Tabela Nr.5 Numri i rrënjëve, prodhimi dhe rendimenti i drufrutorëve, 2010-2020

Numri i rrënjëve, prodhimi dhe rendimenti i drufrutorëve, 2010-2020													
Number, production and yield of permanent crops, 2010 - 2020													
Nr / No	Emërtimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Description
I Pemë frutore													
Fruit trees													
	Gjithsej (000 rrënjë)	10,190	11,225	11,607	11,909	12,254	12,405	12,594	13,130	13,393	13,822	14,038	Total (000 trees)
	Në prodhim (000 rrënjë)	7,439	8,313	8,992	9,292	9,654	10,185	10,575	10,961	11,120	11,579	11,767	In production (000 trees)
	Rendimenti (kg/rrënjë)	22,6	22,6	23,4	23,5	22,8	24	25	24	25	24	23	Yield (kg/tree)
	Prodhim (000 ton)	167,8	188,1	210	218	220	245	261	263	274	274	274	Production (000 ton)
II Ulinj													
Olives trees													
	Gjithsej (000 rrënjë)	6,255	7,443	8,000	8,620	8,994	9,225	9,608	9,786	10,008	10,288	10,532	Total (000 trees)
	Në prodhim (000 rrënjë)	4,298	4,576	4,829	5,277	5,803	6,332	6,643	7,442	7,798	8,226	8,616	In production (000 trees)
	Rendimenti (kg/rrënjë)	16,3	14,3	22	14,7	16,9	12	15	14	15	12	15	Yield (kg/tree)
	Prodhim (000 ton)	70	65,4	108	92	98	96	99	108	118	98	132	Production (000 ton)
III Agrume													
Citrus trees													
	Gjithsej (000 rrënjë)	763	916	1,010	1,125	1,200	1,282	1,354	1,394	1,454	1,521	1,589	Total (000 trees)
	Në prodhim (000 rrënjë)	530	589	633	767	859	951	1,044	1,109	1,154	1,265	1,329	In production (000 trees)
	Rendimenti (kg/rrënjë)	25,2	25,5	29,8	26,1	24,4	32	38	37	39	37	37	Yield (kg/tree)
	Prodhim (000 ton)	13,4	15	18,9	20	21	30	40	41	45	47	49	Production (000 ton)
IV Pjergulla													
Pergola													
	Gjithsej (000 rrënjë)	5,501	5,743	5,859	5,974	6,075	6,109	6,197	6,173	6,280	6,434	6,545	Total (000 trees)
	Në prodhim (000 rrënjë)	5,100	5,208	5,380	5,494	5,599	5,655	5,775	5,828	5,872	6,008	6,103	In production (000 trees)
	Rendimenti (kg/rrënjë)	16,2	16	15,2	15,4	15	15	14	14	13	13	13	Yield (kg/tree)
V Vreshta													
Vineyard													
	Gjithsej (ha)	9,712	10,073	10,136	10,178	10,383	10,438	10,533	10,695	10,787	10,842	12,002	Total (ha)
	Në prodhim (ha)	8,630	9,077	9,348	9,579	9,625	9,891	10,011	10,057	10,179	10,255	10,445	In production (ha)
	Rendimenti (kg/ha)	118,6	123,4	123,1	124,5	124,5	124	124	122	108	111	114	Yield (kg/ha)
	Rrësh gjithsej (000 ton)	184,9	195,2	196,8	204,0	203,7	205,0	205,1	202,9	184,8	189,9	199,1	Grape total (000 ton)

Tab. Nr. 6 Subjektet e licencuara te Agroturizmit:

Nr.	Emri i kompanisë	Celular	Email	Adresa	Kapacitetet akomoduese
1	Alfred Fiska P.F.	0682091617	alpetinery@gmail.com	Roshnik-Berat	8
2	Albina Çuko P.F.	0692105543	albinacuko1@gmail.com	Shën-Gjergj, Tiranë	6
3	Qafshatamë sh.p.k.		info@shkrelresort.al	Qafshatamë, Krujë	25
4	Kol Marku P.F.	0684652952	ari_al85@hotmail.com	Katund i Vjetër, Mirditë	6
5	Qemal Alushi P.F.	0682036634	alushiolsi87@gmail.com	Prezë, Tiranë	6
6	Shqipe Huqi P.F.	0684099909	agroturizmihuqi@gmail.com	Radë, Durrës	6
7	Libonike Nurellari P.F.	0695262940	fatosnurellari@yahoo.com	Peshtan, Poliçan	6
8	Agro Gjepali sh.p.k.	0684370437	fundimgjepali@gmail.com	Gjepalaj, Shijak	6
9	Altin Prenga P.F.	0696555252	altinprenga@hotmail.it	Fishtë, Lezhë	9
10	Kodra e Kuajve sh.p.k.	0696090081	kodra_kuajve@yahoo.com	Kodra e Dedejve, Durrës	18
11	Gramozi BR sh.p.k.	0682297081	gramozibr@gmail.com	Poshnje, Berat	7
12	Our Own Expeditions sh.p.k.	0676096010	nancytare@ouroenexpeditions.com	Nivicë, Tepelenë	6
13	Jeton Hida P.F.	0693054121	farmasotira@gmail.com	Ersekë, Korçë	7

Burimi: MTM

Tabela nr. 7. Bujtina

Nr.	Emri i kompanisë	Personi i kontaktit:	Celular	Vendndodhja	Adresa	Kapacitetet akomoduese
1	Bujtina Pepushaj	Besnik Pepushaj	697890149	Shkodër	Lepushë, Kelmend Vermosh	10
2	Bujtina e Fratit	Gjovalin Pellumbaj	692250681	Shkodër	Kelmend Nj.Ad. Ana e Malit	9
3	Agro ferma	Ahmet Sulejmani	673702456	Shkodër	Razëm	6
4	"Kulla e Artë"	Fred Sterkaj	682071580	Shkodër	M. e Madhe, Bogë	15
5	Bujtina Gëzimit	Gëzim Olaj	673036160	Shkodër	M. e Madhe, Vermosh	10
6	Bujtina Tilaj	Vuk Tilaj	692064407	Shkodër	Qebik-Pukë	10
7	Kunora	Nikoll Uka	682313943	Shkodër	Zues Rrethina	6
8	Bujtina Zues	Jetmir Matlia	698504581	Shkodër	Pukë	10
9	Hani- Përparimit	Përparim Laçi	682313943	Shkodër	M. e Madhe, Vermosh	20
10	Bujtina Lumaj	Leonard Lumaj	693030733	Shkodër	Guri i Zi	12
11	Dioniz Marku	Dioniz Marku	692908808	Shkodër	M. e Madhe	3
12	Bujtina Reç	Mirash Markaj	693198026	Shkodër	Fishtë	3
13	Mrizi i Zanave	Altin Prenga	692108032	Lezhë	Troshan	3
14	Hylli Dritës	Fatmir Ndoj	698657614	Lezhë	Tale	2
15	Hani Lekës	Petrit Leka	674301029	Lezhë	Fishtë	3
16	Agostin Luli	Agostin Luli	696905322	Lezhë	Shëngjin	10
17	Oazi	Angjelin Koleci	674656556	Lezhë	Fishtë	2
18	Syni Zi	Luc Lari	673889387	Lezhë	Patog	5
19	Brillanti	Rakip Haxhia	684010702	Lezhë	Skuraj	6
20	Natyra	Gjergj Marku		Lezhë	Rubik	4
21	Marubi	Gjovalin Prenga	682077420	Lezhë	Kroi i Bardhë	6
22	Bujtinat e Kroit të Bardhë	Zef Lleshi	688401194	Lezhë	Fshati Shishtavec	3
23	"Haxhia"	Sejran Haxhia	682938357	Kukës	Valbonë-Tropojë	8
24	"Selimaj"	Adem Selimaj	673380014	Kukës	Valbonë-Tropojë	10
25	"Rilindja"	Alfred Selimaj	673014637	Kukës	Valbonë-Tropojë	12
26	"Natyra"	Avdi Selimaj	673093202	Kukës	Valbonë-Tropojë	8
27	Bujtina Gjana	Diloman Gjana	682595300	Kukës	Kukës	16
28	Bujtina Shtini	Jeton Shtini	682597727	Kukës	Kukës	8
29	Stani i Hoxhës	Gezim Basha	674488884	Kukës	Valbonë-Tropojë	16
30	Jezerca		673093406	Kukës	Valbonë-Tropojë	14
31	"Selimaj"		686815704	Kukës	Valbonë-Tropojë	16
32	Relax		683502088	Kukës	Voskopojë	14
33	Floresha Zëre	Floresha Zëre		Korçë	Tushemisht	
34	Prashqevi Çobani	Prashqevi Çobani	692699375	Korçë	Tushemisht	
35	Nazif Jolldashi	Nazif Jolldashi		Korçë	Voskopojë	
36	Anton Falo	Anton Falo	683369436	Korçë	Tushemisht	
37	Elza Tili	Elza Tili	694795333	Korçë	Zaroshkë	
38	Ilo Todor	Ilo Todor	682604383	Korçë	Tushemisht	
39	Anila Llakmani	Anila Llakmani	692264127	Korçë	Boboshticë	
40	Thoma Lena	Thoma Lena		Korçë	Lin	
41	Astrit Musli	Astrit Musli	692494670	Korçë	Drenovë	
42	Kristaq Roça	Kristaq Roça		Korçë	Pirg	
43	Dafina Beqiraj	Dafina Beqiraj	697625035	Korçë	Boboshticë	
44	Nikoleta Kita	Nikoleta Kita		Korçë	Voskopojë	
45	Alketa Melko	Alketa Melko	692316832	Korçë	Boboshticë	
46	Agim Bulka	Agim Bulka		Korçë	Voskopojë	
47	Klodiana Deda	Klodiana Deda	692593192	Korçë	Boboshticë	
48	Spiro Shkodrani	Spiro Shkodrani	682094104	Korçë	Voskopojë	
49	Marie Pleqi	Marie Pleqi		Korçë	Dardhë	
50	Miranda Seferi	Miranda Seferi		Korçë	Liqenas	
51	Ilo Todor	Ilo Todor		Korçë	Leminot	
52	Krenar Bregu	Krenar Bregu		Korçë	Voskopojë	
53	Oliver Pleqi	Oliver Pleqi		Korçë	Vithkuq	
54	Mimoza Rënxa	Mimoza Rënxa	682912026	Korçë	Voskopojë	
55	Llazar Lera	Llazar Lera		Korçë	Voskopojë	
56	Qamil Avdulla	Qamil Avdulla	692828338	Korçë	Lin	
57	Gerald Grabocka	Gerald Grabocka	692989345	Korçë	Vithkuq	
58	Tre Bujtinat		699205805	Elbasan	Gjinar	22
59	Alvaro Kadiu	Alvaro Kadiu		Berat	Mangalem	
60	Ferdinand Vruhu	Ferdinand Vruhu		Berat	Mangalem	
61	Redian Baci	Redian Baci		Berat	Mangalem	
62	Niko Droboniku	Niko Droboniku		Berat	30 Vjetori	
63	Silvja Meçaj	Silvja Meçaj		Berat	Mangalem	
64	Edmir Hidersha	Edmir Hidersha		Berat	Goricë	
65	Diamanta Bajrami	Diamanta Bajrami		Berat	Kala	
66	Remi Berberi	Remi Berberi		Berat	Iliria	
67	Enis Haxhijaj	Enis Haxhijaj		Berat	Muzakaj	
68	Ela Dingo	Ela Dingo		Berat	Çlirim, Berat	
69	Alfred Fiska	Alfred Fiska		Berat	Roshnik	
70	Vasilika Gogu	Vasilika Gogu		Berat	Mangalem	
71	Qemal Alushi	Qemal Alushi	682036634	Tiranë	Prezë	4
72	Hajdar Kuçi	Hajdar Kuçi	682026856	Durrës	Marikaj	3
73	Zeqir Mustafaj	Zeqir Mustafaj	672084777	Tiranë	Mucaj	0

(Vijon nga faqja 7)

Çështje për diskutim në Tryezën Tematike: “Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisi në zonat rurale në Shqipëri”

hallka me rëndësi të veçantë, që kondicionojnë ndjeshëm zhvillimin e sektorëve të sipërcituar dhe jo vetëm si, toka bujqësore, uji, klima, mjedisi, pyjet, livadhet, kullotat, që analizuam më sipër, por edhe për: Fushën e mekanizimit, inovacionit, dhe dixhitalizimit, financat, mikrofinanca, disbursimi fondeve grant, përmirësimi legjislativ, integrimi rajonal. European dhe Euro Atlantik.

II Mekanizimi, inovacioni dhe dixhitalizimi në sektorin bujqësisë:

Shqipëria aktualisht nuk e ka akoma nivelin e domosdoshëm të kërkuar për mekanizimin, inovacionin dhe dixhitalizimin e sektorit të bujqësisë, por dhe hallkave kryesore të zinxhirit ushqimor. Numri i traktorëve bujqësorë në përdorim është rreth 10 mijë nga 15 mijë që i nevojiten gjithësej, për të përballuar në kohë periudhat kulmore të punimeve. Traktorët në përdorim në masë të madhe janë të prodhuar më shumë se 20 vite më parë, me një teknologji të vjetër, shumë marka traktorësh aktualisht nuk prodhohen dhe nuk gjenden më pjesë këmbimi në treg. Nga numri i traktorëve në punë vetëm 2000 traktorë plotësojnë kriteret e BE për t'u përdorur me efikasitet në punimet bujqësore. 54 % e familjeve fermerë mund të përdorin mjetet e mekanizuara për punimin e tokës, për kultivimin dhe vjeljen e bimëve, 46 % e tyre e kanë të pamundur përdorimin e mjeteve të mekanizuara për punimet në bujqësi. Ata akoma përdorin krahët dhe kafshët e punës.

Shqipëria përdor me efikasitet mesatarisht 1.24 traktorë për 100 ha tokë të punuar. Ndërsa Maqedonia e Veriut 6 traktorë, Greqia 6.6 traktorë, Italia 13.2 traktorë, shtetet e Bashkimit Evropian 8.1 traktorë për 100 ha tokë.

Gjithashtu Shqipëria në procesin e punimit të tokës, vjeljes dhe kultivim bimësh përdor 1.5 - 2 makineri bujqësore për traktor, vendet e rajonit jo në BE përdorin mesatarisht 5 - 7 të tilla, ndërsa vendet e Bashkimit evropian 13 makineri bujqësore për traktor.

Formalizimi, plotësimi dhe rinovimi parkut të traktorëve bujqësor dhe makinerive për kultivimin dhe në veçanti për vjeljen e prodhimit mbetet një sfidë, që sektori publik, ai

privat dhe me asistencë të donatorëve, duhet të punojmë pa rreshtur, që ta futin në rrugën e zgjidhjes pahumbur kohë.

Hapi parë me rëndësi në këtë drejtim nga qeveria është hedhur duke reduktuar me mbi 50 % çmimin e karburantit që përdoret për punimet kryesore në bujqësi. Situata që po kalojmë na obligon të ndërmarrim hapa të tjerë pa humbur kohë.

Inovacioni dhe Dixhitalizimi

Janë në hapat e para të përdorimit dhe duhet theksuar se në këtë drejtim në bujqësi janë krijuar kushtet që të ecet me ritme më të shpejta. Shqipëria ka një kuadër ligjor bashkëkohor në mbështetje të inovacionit dhe dixhitalizimit të sektorit të bujqësisë dhe të gjitha hallkave kryesore të zinxhirit në fushën e Ekonomisë së Ushqimit.

Përdorimi metodave inovative në ndërtimin e serrave për prodhimin e farëve dhe fidanave që garantojnë rezistencë ndaj ndryshimeve klimatike dhe rrisin rendimentin po jep frytet e para. Prodhimi primar në serra përmes metodës inovative të hidroponisë ka dhënë rezultate mjaft pozitive edhe në vendin tonë dhe duhet nxitur, përkrahur e mbështetur, që prodhimi të rritet dhe sipërfaqja të zgjerohet më tej. Gjithashtu krahas përdorimit të disa metodave dhe platformave dixhitale si e-Albania, të cilat po shërbejnë për lehtësimin e shërbimeve, informim të fermerëve, për aplikime të ndryshme për mbështetje financiare, duhet që paralelisht të mbështeten edhe iniciativat e sektorit privat të marra në fushën e dixhitalizimit, të cilat po u shërbejnë fermerëve përveç informimit edhe për t'i asistuar procesin e formalizimit të mekanikës bujqësore, të koordinimit midis hallkave të zinxhirit të sektorëve të Ekonomisë së Ushqimit.

Shoqata e Kursim Kredisë FED INVEST me mbështetjen e qeverisë së Japonisë përmes Agjencisë JICA po punon me platformën elektronike ABA ONLINE, e cila duhet përkrahur e mbështetur si një iniciativë e përvojë mjaft dobiprurëse e sektorit privat në këtë sektor.

Pyetjet që shtrohen dhe kërkojnë përgjigje:

tokës për kullota ose kultura. Sipas ambientalistit britanik Norman Myers, 5% e shpyllëzimit është për shkak të blegtorisë së bagëtive, 19% për shkak të prerjeve tepër të rënda, 22% për shkak të sektorit në rritje të plantacioneve të vajit të palmës dhe 54% për shkak të bujqësisë së prerë dhe djegur.

Shpyllëzimi shkakton humbjen e habitatit për miliona

Pse qeveria nuk po krijon kushte normale dhe nuk po vlerëson propozimet dhe kërkesat e KASH, për paisjen e mjeteve të mekanikës bujqësore me targa, me leje qarkullimi, me qendra kolaudimi?

Pse nuk hartohet dhe të vihet në funksion në dobi të fermerëve një Regjistër Kombëtar për mjetet e mekanikës bujqësore, serrat me ngrohje dhe subjekteve agropërpunuese?

Pse nuk merren masa dhe të programohet furnizimi bujqësisë dhe peshkimit me karburant të prodhuar dhe përpunuar në vend?

Sa dhe si duhen mbrojtur dhe mbështetur me investime, zhvillimi dhe mirëmbajtja e platformave elektronike të inicuar dhe ndërtaura nga sektori privat?

III. Financimi, Mikrofinanca dhe Disbursimi Fondeve Grant:

Burimi kryesor për financimin e veprimtarisë në sektorin e bujqësisë, turizmit dhe mjedisit në zonat rurale vjen nga të ardhurat e siguruar nga aktiviteti në vend dhe remitanca të dërguara nga emigrantët që punojnë jashtë vendit. Remitanca kanë qenë, janë dhe do të mbeten edhe për shumë kohë një burim i pazëvendësueshëm financiar në të tre grupimet që u përmendën më sipër, për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, turizmit dhe mjedisit në zonat rurale në Shqipëri. Situata që po kalojmë kërkon një mbështetje konkrete dhe nxitje për emigrantët, që të mos e braktisin financimin e projekteve të nisura në bashkëpunim me familjet e tyre, që aktualisht vazhdojnë të banojnë e punojnë në fushën e bujqësisë, turizmit dhe mjedisit në zonat rurale. Të mos i braktisin investimet për tokën duke e lënë atë djerrë, po ashtu edhe pasuritë e tjera që ata kanë në zonat rurale. Me emigrantët që kanë investuar e vazhdojnë të investojnë duhet takuar e biseduar më shpesh si në vendet ku aktualisht banojnë edhe kur vijnë në Shqipëri, për të biseduar e bashkëpunuar për rritjen e efikasitetit të investimeve të tyre, por edhe për shitjen e produkteve të tyre Made in Albania në vendet ku Ata kanë emigruar.

Burim tjetër financiar me

shumë rëndësi që mbështesin sektorin privat në bujqësi janë fondet e buxhetit të shtetit të programuara për MBZHR, si dhe kreditë nga bankat e nivelit të dytë. Bujqësia dhe Turizmi rural megjithëse japin mbi 20 % të PPB të vendit. MBZHR financohet nga buxheti shtetit për shpenzime operative dhe investime me rreth 2.2 %/vit të shpenzimeve totale të tij.

Kreditimi nga bankat e nivelit të dytë është mesterisht 1.5 % e totalit/vit të kredisë që ato japin. Shpenzimet nga buxheti shtetit për MBZHR, për vitin 2022 janë programuar 2 % më pak se sa 2021.

Shoqëritë e mikrofinancës janë ndër institucionet kredituese që kanë financuar dhe vijojnë të financojnë sektorët me përparësi. Ato kreditojnë Bujqësinë dhe Turizmin rural me mbi 25 % të buxhetit të kredive që japin. Shoqata anëtare e KASH, “FED INVEST”, krediton sektorin e Bujqësisë dhe Turizmit rural me mbi 50 % të buxhetit të kredive. Politika e kreditimit të shoqërive të mikrofinancës mundëson kreditimin në masë të gjerë në të tre grupimet e fermerëve të përmendur më sipër. Fuqizimi, mbështetja dhe përkrahja e veprimtarisë së tyre është mjaft dobiprurëse për të tre grupimet e fermerëve.

Burimi financiarit me fonde grant të donatorëve dhe ato nga buxheti i shtetit, veçanërisht në kushtet e krijuara në këto tre vitet e fundit konsiderohet me shumë rëndësi sepse:

Paketa fiskale veçanërisht ajo për bujqësinë është ndryshuar shpeshherë dhe brenda një kohe të shkurtër, pa u studiuar pasojat negative dhe pa u konsultuar paraprakisht me grupet e interesit. Ajo ashtu si është formuluar aktualisht po rezulton që nuk është dobiprurëse as për fermerët dhe as për buxhetin e shtetit. Sektorët e bujqësisë dhe turizmit rural janë përballur me disa fatkeqësi natyrore të pazakonshme dhe jo vetëm duke pësuar humbje të mëdha si nga:

- Tërmeti 26 nëntorit 2019 dhe nga pandemia covid - 19.

- Konjuktura ndërkombëtare e çmimit të blerjes së lëndëve të para, inputeve, pajisjeve e makinerive u rrit derisa edhe

u dyfishua në shumë artikuj pa prituri brenda një periudhe kohe shumë të shkurtër.

- Kushtet klimatike u përkeqësuan ndjeshëm dhe mesatarisht dëmi shkaktuar prej tyre sipas BB shkon në rreth 147 milion euro/vit. Përballimi i dëmeve me financime nga shoqëritë e sigurimit dhe kompensimi nga buxheti i shtetit është fare i papërfillshëm.

- Konkurrenca nga vendet e rajonit dhe më gjerë është bërë më agresive dhe financimet grant të tyre për bujqësinë dhe turizmin rural janë disa herë më të mëdha se sa programon Shqipëria, e cila ka edhe më shumë nevojë se sa ato edhe për financimin e investimeve të munguara nga e kaluara.

Të gjithë faktorët negativë që u përmendën më sipër nuk kanë ndikuar negativisht në këto përmasa 3 vite më parë, ndërsa financimet nga buxheti në këto tre vite për MBZHR kanë ndryshuar fare pak, apo në disa tregues aspak ose janë përkeqësuar.

Pyetjet që shtrohen dhe kërkojnë përgjigje:

A duhet pezulluar dhe ndryshuar Paketa Fiskale për sektorët e Ekonomisë së Ushqimit e cila u fut në zbatim në janar 2022?

A mund ta përballojë me buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të miratuar për MBZHR situatën e re të krijuar dhe sa duhet të rritet buxheti për MBZHR?

A duhet rishikuar gjithë procesi i subvencionimit në Shqipëri, për ta përafëruar me rajonin dhe BE?

A duhet që të jenë pjesë e përfitimit nga garancia sovranë, që jepet për kolateralin në zonat rurale krahas bankave të nivelit të dytë edhe shoqëritë e kursim kredisë për kreditë që ato japin në zonat rurale?

IV. Fusha e Përmirësimit të Legjislativitetit dhe Përafërimit me atë të BE.

Përmirësimi i legjislativitetit dhe përafërimit me atë të BE në fushën e Bujqësisë, Turizmit Rural, dhe Mjedisit në Zonat Rurale është një proces mjaft dobiprurës, por që duhet vlerësuar akoma më shumë për situatën që po kalojmë dhe për të

ardhmen e afërt.

KASH ka evidentuar disa nga mangësitë dhe ka bërë disa propozime konkrete, për përmirësimin e situatës. Konkretisht në këtë fushë kemi propozuar prej kohësh që duhen përmirësuar e miratuar njëkohësisht dhe në bllok përmes një pakete të vetme:

Ligji 7501 dt 19.07.1991 “Për Tokën” i ndryshuar.

Ligji 7928 dt 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” TVSH i ndryshuar.

Ligjit nr 8669 datë 26.10.200 “Për Rregjistrimin e Përgjithshëm të Popullsisë dhe Banesave”.

Ligjit nr.7747 datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)” i ndryshuar;

Ligji nr. 10465 dt. 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar ne Republikën e Shqipërisë”

Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë; Miratuar me ligjin me nr. 8378 date 22.07. 1998, ndryshuar me ligjin nr. 9808 date 24.09. 2007 dhe ligjin nr. 10488 date 05.12.2011.

Ligji nr. 62/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”;

Ligji nr. 9817 datë 22.10.2007 “Për Zhvillimin Bujqësor Rural”.

Ligji 10431 /2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”

Ligji 10463/2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”;

Hartimi dhe miratimi pa humbur më shumë kohë i një ligji të ri “Për Sigurimet e pronës dhe prodhimin në hallkat kryesore të Ekonomisë së Ushqimit”.

Pyetje që shtrohen dhe kërkojnë përgjigje:

A është e mundur nga pikpamja e teknikës legjislative dhe më dobiprurëse për mbarëvajtjen e Ekonomisë së Ushqimit, që procesi i përmirësimit të legjislativitetit i propozuar nga KASH, të hartohet e miratohet në bllok përmes një pakete ligjore të vetme?

Sa kohë dhe fonde do t'i duhen një projekti pilot, ose një studioje ligjore e specializuar në këtë fushë, për të bërë ndryshimet ligjore të kërkuara nga KASH dhe MBZHR, për t'i miratuar ato në një paketë të vetme?

(Vijon nga gazeta 435)

Rreth 31% e sipërfaqes së tokës së Tokës aktualisht është e mbuluar nga pyjet. Kjo është një e treta më pak se mbulesa pyjore para zgjerimit të bujqësisë, gjysma e asaj humbjeje të ndodhur në shekullin e kaluar. Nga 15 deri në 18 milionë hektarë pyje, një sipërfaqe sa Belgjika, shkatërrohen çdo vit. Mesatarisht 2400 pemë priten çdo minutë.

Shpyllëzimi po pastron pyjet e Tokës në një shkallë të gjerë në mbarë botën dhe rezultojnë në shumë dëmtime të tokës. Një nga shkaqet e shpyllëzimit është pastrimi i

Efektet kryesore të bujqësisë mbi mjedisin janë çështjet e rëndësishme mjedisore dhe sociale që lidhen me prodhimin bujqësor që përfshijnë ndryshimet në ciklin hidrologjik, futjen e kimikateve toksike, lëndëve ushqyese dhe patogjenëve

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

specie, dhe është gjithashtu një nxitës i ndryshimeve klimatike. Pemët veprojnë si një lavaman karboni: domethënë, ato thithin dioksid karboni, një gaz i padëshiruar serrë, nga atmosfera. Heqja e pemëve lëshon dioksid karboni në atmosferë dhe lë pas më pak pemë për të thithur sasinë në rritje të dioksidit të karbonit në ajër. Në këtë mënyrë, shpyllëz-

imi përkeqëson ndryshimin e klimës. Kur pemët hiqen nga pyjet, tokat priren të thahen sepse nuk ka më hije dhe nuk ka pemë të mjaftueshme për të ndihmuar në ciklin e ujit duke rikthyer avujt e ujit në mjedis. Pa pemë, peizazhet që dikur ishin pyje mund të shndërrohen në shkretëtirë djerrë. Rrënjët e pemës gjithashtu ndihmojnë në mbajtjen e tokës së bashku,

kështu që kur ato hiqen, mund të ndodhin edhe rrëshqitje balte. Largimi i pemëve shkakton edhe luhataj ekstremë të temperaturës.

Në vitin 2000, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) zbuloi se “roli i dinamikës së popullsisë në një mjedis lokal mund të ndryshojë nga vendimtar në i papërfillshëm”

dhe se shpyllëzimi mund të rezultojë nga “një kombinim i presionit të popullsisë dhe stagnimit ekonomik, social dhe kushtet teknologjike.”

Ulja e madhësisë së ndotjes së bujqësisë

Në prodhimin e bimëve, masat e menaxhimit për reduktimin e rrezikut të ndotjes së ujit për shkak të plehrave organike dhe inorganike dhe pesticideve përfshijnë kufizimin dhe optimizimin e llojit, sasisë dhe kohës së aplikimeve në kulturat bujqësore. Bujqësia

(Vijon në faqen 15)

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

Toka është i vetmi planet në Univers ku ka jetë. Ndaj është shumë e nevojshme të mirëmbahen pasuritë natyrore të tokës, për të vazhduar jetën në tokë. Njeriu ka haruar të kujdeset për planetin që i dha jetën dhe i përdor burimet e tij në mënyrë të pamëshirshme.

Senatori amerikan Gaylord Nelson, themeloi Ditën e Tokës për t'i ndërgjegjësuar njerëzit për rritjen e përditshme të industrializimit, si dhe qëndrimin e pakujdesshëm të njerëzve që jetojnë në tokë. Hapi u mor nga ai për të promovuar idenë e ekuilibrit natyror midis njerëzve si dhe për t'i inkurajuar ata për respektimin e burimeve të planetit. Është shumë e nevojshme të kujdesemi për çështjet mjedisore për të qëndruar të shëndetshëm dhe të gjallë, pasi njerëzit kanë shfrytëzuar pa mëshirë burimet e jetës gjatë shekujve.

Një nga shembujt më të mëdhenj është shterimi i shtresës së ozonit që na pengon nga rrezet ultraviole të diellit. Një tjetër problem i madh i mjedisit është shkatërrimi i lumenjve duke u përzier me materialet toksike industriale që çon në ngrohjen globale. Rritja e industrializimit, çon në shpyllëzimin që përfundimisht çon në rritjen e temperaturës së Tokës. Çdo gjë është duke u paketuar në qese plastike. Prodhimet e qeseve plastike po rriten dita ditës, të cilat sjellin dëme për mjedisin, pasi këto materiale janë të padegradueshme.

Këto janë disa nga rreziqet që mbarojnë jetën në tokë, të cilat mund të reduktohen duke ndërmarrë hapa të vegjël si mbjellja e pemëve të reja, duke penguar shpyllëzimin, duke kufizuar përdorimin e automjeteve për të reduktuar ndotjen e ajrit, duke rritur ruajtjen e energjisë përmes reduktimit të përdorimit

HUMBJA NËPËRMJET URBANIZIMIT DHE INDUSTRIALIZIMIT TË TOKËS BUJQËSORE

të panevojshëm të energjisë elektrike. Hapa të tillë të vegjël bëhen një hap i madh nëse merren me kujdes nga njerëzit në mbarë botën.

Procesi i urbanizimit dhe industrializimit shoqërohet gjithmonë me një ndikim të drejtpërdrejtë në humbjen e cilësive dhe pjellorisë së tokës bujqësore. Ky ndikim është i natyrës së drejtpërdrejtë që shqërohet me humbjen e sipërfaqeve faktike të tokës bujqësore dhe indirekt në humbjen e funksioneve kryesore të saj.

Aktualisht në rang botëror si pasojë e këtij procesi humbasin me mijëra ha tokë produktive çdo vit. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për vendin tonë, ku si pasojë e zhvillimeve demografike të pakontrolluara si dhe të zhvillimit të industrisë në zonën më të zhvilluar bujqësore vihen re një shfrytëzim i pakontrolluar i tokës bujqësore dhe humbje e konsiderueshme e sipërfaqes.

Të dhënat statistikore që rezultojnë nga implementimi i Programit Menaxhim i Qëndrueshëm të Tokës Bujqësore, tregojnë që vetëm në 30 vitet e fundit si pasojë e këtyre zhvillimeve urbane dhe procesit të industrializimit, kemi një humbje të konsiderueshme të sipërfaqes së tokës bujqësore i cili ndryshon sipas rajoneve.

Të dhënat mbi sipërfaqen e tokës bujqësore të zënë me ndërtime kanë dalë nga shfrytëzimi i të dhënave të vijës kufizuese (Vija e verdhë) në njësitë administrative të para viteve 1990 dhe dixhitalizimit të ndërtimeve në tokën bujqësore jashtë vijës së verdhë.

Nisur nga të dhënat e mësipërme rezultojnë sipërfaqja e tokës bujqësore në 9 njësi administrative është ulur me 2576.9 ha. Matematikisht në shkallë vendi humbja e tokës bujqësore shkon mbi 100 mijë ha por, nuk mund ta pra-

teve industriale në këtë rajon është shumë i madh.

Është për t'u theksuar fakti që zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e

Nr.	Njësia administrative	Bashkia	Kategoria e Tokës	Sipërfaqja në Ha sipas viteve		
				1995-1998	2010-2016	Ndryshimi
1	Synej	Kavajë	Tokë bujqësore	2768.5	2508.6	-259.9
			Tokë jobujqësore	848.5	1057.7	209.2
2	Xarrë	Sarandë	Tokë bujqësore	2503	2467.2	-35.8
			Tokë jobujqësore	748.5	784.7	36.2
3	Cakran	Fier	Tokë bujqësore	5041.6	4021.6	-1020
			Tokë jobujqësore	873.6	903.8	30.2
4	Kutalli	Ura Vajgurore	Tokë bujqësore	3744.3	3739.7	-4.6
			Tokë jobujqësore	661	684.3	23.3
5	Mbrostar	Fier	Tokë bujqësore	3497.5	3344.7	-152.8
			Tokë jobujqësore	643.3	795.8	152.8
6	Strum	Roskovec	Tokë bujqësore	2770.9	2746.2	-23.8
			Tokë jobujqësore	277.2	302	24.8
7	Shalës	Cërrik	Tokë bujqësore	2221.2	2225.8	-4.6
			Tokë jobujqësore	558.1	573.9	15.8
8	Pojan	Maliq	Tokë bujqësore	5219	4831.2	-387.8
			Tokë jobujqësore	858.7	1075.9	217.2
9	Vreshtas	Maliq	Tokë bujqësore	5186.6	4498.4	-688.2
			Tokë jobujqësore	510.7	498.2	-12.5

nojmë pa përfunduar studimi për faktin që presioni i migrimit të brendshëm të popullsisë mbi tokën bujqësore nuk është i njëjtë për të gjitha njësitë administrative.

Ndërkohë nuk duhet të mohojmë faktin që në rajonin (trekëndëshin) që prek Tiranën, Durrës dhe Lezhë humbja e tokës bujqësore është e pallogaritshme për faktin se në këtë rajon dyndja e popullsisë për ndërtim dhe i ngritjes të objek-

tokës bujqësore është përgjegjësi e të gjithë institucioneve lokale dhe atyre qendrore në vend. Sipërfaqja për frymë e tokës bujqësore nuk na ofron luksin për shpërdorim, degradim apo keqmenaxhim të tokës bujqësore.

*Përgatitën: Shpëtim Tafaj, Drejtor i Shërbimit të Tokës dhe Ujërave
Suada Luzati, Përgjegjëse e Sektorit të Hartografisë dhe Përdorimit të Tokës.*

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

Toka është mbështetja esenciale e jetës njerëzore, jo vetëm në lidhje me furnizimin me produkte bujqësore dhe blegtorale, por gjithashtu për prodhimin e tekstileve dhe strehim.

Rritja e shpejtë e shkallës së përdorimit të tokës si rezultat i presioneve nga popullata, teknologjitë e përdorura dhe zhvillimi industrial, ka shkaktuar përshtetimin e degradimit të tokës në shumë vende të botës.

Tokat e kripura shtrihen rreth 40.000 ha të lokalizuara në pjesën bregdetare të vendit, nga Xara e Sarandës dhe deri në Velipojë në Shkodër. Në Sarandë tokat e kripura shtrihen në Vrinë, në rrethin e Vlorës tokat e kripura shtrihen në Zvernec, Akërn, Pishë-Poro dhe Novoselë. Në qarkun Fier këto toka shtrihen në Hoxharë, Topojë, Ndërmenas, Levan, Libofshë, Seman, Seman plazh etj. Në rrethin e Lushnjës shtrihen në Rremas, Bedat, Divjakë, Krutje, Savër, Plug. Në Durrës shtrihen në Qerret, Spital, Spille, Jube, në Krujë, në Adriatik, në Lezhë në Ishull Lezhë dhe Tale, në Shkodër në Velipojë. Në qarkun e Fierit rreth 20.000 ha tokë në zonën perendimore të Qarkut janë me probleme kripëzimi. Mund të përkrahjet si fusha më e sheshtë e vendit me një pjerrësi tepër të vogël drejt detit

TOKAT E KRIPURA, SHTRIRJA DHE ALTERNATIVAT E PËRMIRËSIMIT TË TYRE

Adriatik, që varion ndërmjet 0.0 dhe 0.5 %. Pjesa më e madhe e fushës ka një lartësi jo më të madhe se 5 m mbi nivelin e detit, ndërsa pjesa tjetër më në thellësi shkon 8-10 m.

Ka shumë shkaqe të mundëshme për degradimin e tokës: përmbajtjet me ujë dhe ngjeshja, erozioni, acidifikimi, kripëzimi dhe sodimi. Të gjithë këto dhe në veçanti kripëzimi dhe sodimi, mund të reduktojnë vlerën e përdorimit të tokës në zonat më fushore të vendit. Dhe tani, më mirë ha kanë dalë jashtë kultivimit sepse ato janë bërë shumë të kripura dhe si pasojë kanë pësuar një reduktim të thellë dhe ndryshim të kushteve të mjedisit tokësor.

Faktorët e degradimit të tokës janë faktor kimik, fizik, biologjik dhe procese të tjera specifike të cilat ulin pjellorinë e tokës dhe si rezultat struktura e tokës shkatërrohet, lëndë organike pakësohet dhe bashkë me të edhe lëndët ushqyese, (azoti, fosfori, potasi, sqfuri, magnezi dhe sasi më të vogla mikroelementesh). Sasi shumë të mëdha azoti, sqfuri, kalciumi dhe magnezi mund të humbasin me anë të shplarjes në kushtet e një mjedisi tokësor të lagët. Në kushtet e një

regjimi hidrik dhe ajrore të përqësuar, humbjet e azotit rriten së tepërmi në sajë të denitrifikimit biologjik dhe kimik. Oksidet e azotit (NO dhe N₂O), produkte të denitrifikimit mikrobial largohen nga toka në atmosferë duke u implikuar kështu në ngrohjen globale.

Nëse drenazhimi i brendshëm i profilit të tokës është i pamjaftueshëm për të kulluar tokën, kripërat e sjella me ujë dhe ujët mund të ngrihen në sipërfaqe të tokës si rezultat i normave të larta të avullimit. Ripërdorimi i ujit të drenimit për ujë përshpejton procesin e kripëzimit. Kripëzimi i shtresës aktive të tokës ndodh gjithashtu si rezultat i kapilaritetit të rritur të profilit të tokës. Kalimi i kripës nga uji nëntokësor si rezultat i difuzionit dhe infiltrimit nga kanalet kulluese në sipërfaqe të tokës krijon kripëzimin e dytë.

Një problem tjetër i lidhur me ujitjen e induktuar është alkaliteti ose sodimi. Sodimi është përqindje e natriumit të këmbëshëm. Impakti i saj manifestohet në prishjen e strukturës së tokës. Përdorimi i ujit në zonat me kripëzim të rritur më shumë se 15% Na të këmbëshëm çon në formimin e tokave alkaline ose sodike,

nëpërmjet procesit të hidrolizës. Aplikimi i ujit për ujë me përmbajtje të lartë bikarbonate të sodiumit ose karbonate sodiumi në toka me përmbajtje të ulët Ca dhe Cl, në këto kushte thërmijet e argjilit thithin kripërat e sodiumit dhe magnezit dhe kështu humbin përshkushmërinë e tyre duke krijuar kushte të papërshtatshme për difuzionin e ujit dhe O₂ për rrënjët e bimëve dhe mikroorganizmat.

Kripëzimi i tokës përbën rrezikun kryesor të bujqësisë së ujitur. Bujqësia e ujitur në një mjedis të thatë dhe gjysëm të thatë sjell në vetvete rrezikun e degradimit të tokës si rezultat i kripëzimit dhe sodimit. Në zgjerimin e tokave të kripura dhe ato me probleme kripëzimi, mendojmë se kanë ndikuar një sërë faktorësh. Ndër më të rëndësishmit mund të përmendim:

- Funksionimi jo i mirë i rrjetit kullues në zonën fushore bregdetare, që ka sjellë ngritjen e nivelit të kripërave në shtresat e sipërme të sipërfaqes së tokës.

- Përdorimi i ujërave me përmbajtje të lartë kripërash dhe në shumë raste të paanalizuara më parë.

- Përdorimi i ujërave të kripura për ujë,

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

(Vijon nga faqja 11)

të marra nga sistemi i kullimit dhe ujërat nën-tokësore.

• Mungesa e kultivimit të tokave për një kohë të gjatë ose abandonimi i tyre në më shumë se 15 vjet.

• Menaxhimi jo i mirë i tokave të rrezikuara nga kripëzimi dhe sodimi (cilësia e ujërave, dinamika e ujërave sipërfaqësore, drenazhimi, shkalla e kultivimit, sistemi i kulturave etj.)

• Përdorimi pa kriter i plehrave kimike dhe kimikateve të ndryshme në zona të veçanta me aktivitet intensiv, sidomos në kulturat perimore në serra.

• Ndikimi i formacioneve tokëformuese të tokës dhe infiltrimet e ujit të detit dhe kënetat me të cilat kufizohen tokat e kësaj zone.

DINAMIKA E TOKAVE TË KRIPURA NË VITE

Qarku dhe shtirja e tokave	Sipërfaqja e tokave të kripura ha në vite				
	1960	1975	1984	2004	2016
Durrës					
Qerret					
Spitall	3700	2900	1768	1917.9	3000
Spille					
Jub					
Fieri					
Hoxharë					
Topoje					
Ndërnenas	7500	600	4705	4378.2	6200
Levan					
Libofsh					
Seman					
Seman plazh					
Krujë	1400	1000	747	338	1100
Adriatik					
Laç	1400	800	747	1500	2200
Fushë kuqe					
Lezhë					
Ishull Lezhë	2200	800	156	159.4	1700
Tale					
Lushnje					
Rremas Bedat					
Divjakë	18700	8000	4465	2969	8200
Savër					
Krujë					
Ptyk					
Sarandë	1100	700	507	245.3	700
Vrine					
Shkodër					
Vellipojë					
Baks Rjoll	1300	1000	724	180	700
Plazh Vellipojë					
Malkolaj					
Vlorë					
Zvernec					
Akerni	3300	3000	2780	2336	4500
Pishë Poro					
Novoselë					
Në shkallë	38400	23800	16052	14023.8	28300

Disa nga rrugët e përmirësimit të tokave të kripura

Përcaktimi i masave për shkripëzimin e tokave dhe përmirësimin e tyre mbështetet në shkallën, natyrën dhe tipin e kripëzimit. Treguesit bazë janë përmbajtja e përgjithshme e kripave, si dhe përmbajtja e klorit dhe natriumit të këmbësorëve.

Përcaktimi i natyrës së kripëzimit mbështetet në vlerën e raportit midis joneve të klorit dhe sulfatëve të shprehura në miliekuivalent. Kur vlera e raportit Cl:SO₄ është më shumë se 5, natyra e kripëzimit është klorur, 1-5 është kloruro-sulfat, 0.2-1 është sulfato-klorur dhe kur vlera është më e vogël se 0.2 natyra e kripëzimit është sulfat.

TOKAT E KRIPURA SHTRIRJA DHE ALTERNATIVAT E PËRMIRËSIMIT TË TYRE

Mbi bazën e këtyre klasifikimeve përcaktohen masat shkripëzuese që duhen zbatuar për një përvetësim të shpejtë të tokave të kripura, proces i cili kalon në dy faza:

Faza e parë:

Masa hidroteknike:

Funksionimi i hidrovorëve dhe rrjetit kryesor kullues: Për këtë është i domosdoshëm funksionimi i rregullt gjithëvjetor i hidrovorëve, duke mbajtur nivelin në hyrje të vaskave në kuotat e projektuara. Në mënyrë të veçantë nuk lejohet rritja e nivelit të ujit në kanalet kryesore gjatë verës, pasi bëhet shkak për ngadalësim të procesit të shkripëzimit të tokave dhe në raste të veçanta mund të çojë në rikripëzim të tyre.

Rrjeti i tretë kullues: Ndërtohet dhe mirëmbahet sipas parametrave të projektit. Thellësia e tij duhet të jetë jo më pak se 1.8-2.0 m në toka të rënda e të mesme, 1.3-1.5 m në tokat e lehta dhe në tokat ranore 0.8-1.0 m. Ky rrjet është hallka kryesore që ndikon në largimin e kripërave nga ngastra kur mbahet sipas projektit ose në rikripëzim të saj kur nuk pastrohen.

Rrjeti i ujitës: Në fazën e parë, kur përqendrimi i kripërave është mbi 1% nevojiten sasi të mëdha uji për shpëlarje, gjë që duhet të mbahet parasysh gjatë projektimit të rrjetit ujitës. Për fazat e mëvonshme të përvetësimit normat e ujitjes duhet të jenë 5000-5500 m³/ha në varësi të bimëve që do të mbillen. Kur përqendrimi i kripërave në tokë ulet nën 1% uji i këtij rrjeti do të përdoret për ujitjen e bimëve që mbillen me kusht që ai si rregull të mos përmbajë sasira kripërash mbi 1 g/liter. Rrjeti ujitës mbahet në gatishmëri për të siguruar ujitje gjithëvjetore. Në tokat e kripura ranore ujitja me shihedhje është e domosdoshme.

Nivelimi sipërfaqësor: Është masë që u paraprin punimeve shkripëzuese. Sistemimi bëhet me projekt dhe ruan pjerrësinë natyrale në drejtim të rrjetit të tretë kullues.

Shkrifërimi në thellësi dhe drenazhimi: Në tokat e rënda dhe të mesme me përmbajtje kripërash mbi 1% bëhet shkrifërimi në thellësi 70-80cm e largësi përkatësisht 1 dhe 2 m paralel me kanalet e tretë kullues. Në tokat me përmbajtje kripërash nën 1% thellësia e shkrifëritimit zvogëlohet duke përdorur shkrifërues të thellësive me të vogla (40-50 cm). Në tokat që janë

nën kulturë dhe përqindja e kriprave në shtresën 50 cm është nën 0.6 %, kullimi mund të realizohet me drenazh të mbyllur.

Gipsimi: Kur natriumi akumulohet në tokë, teknikat e menaxhimit kanë për qëllim uljen e nivelit të natriumit. Gipsi i shtuar në tokë mund të shkaktojë ndryshim të përshkueshmërisë me anë të rritjes të përqendrimit të elektrolitit dhe efekteve të shkëmbimit të kationeve. Sasia e gipsit të nevojshëm për përmirësimin e tokës varet nga sasia e Na të këmbësorëve në profilin e tokës.

Dozat e gipsit sipas përmbajtjes së Na të këmbësorëve në tokë janë si më poshtë:

Niveli i Na të këmbësorëve në mek/100 g tokë të thatë	Sasia e gipsit (CaSO ₄ ·2H ₂ O) Ton/ha
1	4.25
2	8.4
3	12.75
4	17
5	21.25
6	25.5
7	27.75
8	34
9	38.25
10	42.5

Sasia e gipsit të nevojshëm mund të përdoret e ndarë në dy vjet. Sasia e çdo viti përdoret në këtë mënyrë: ½ në plugim 21-25 cm dhe pjesa tjetër në diskim ose frezim. Në se do të përdoret e gjithë sasia e gipsit brenda vitit, shpërndarja bëhet si në rastin e vitit të parë. Në përcaktimin e sasisë së gipsit që do të përdoret gjatë vitit, merret parasysh edhe sasia e ujit që përdoret për shpëlarje si dhe uji i rreshjeve apo i ujitjeve, lidhur kjo me shkallën e tretshmërisë së gipsit në ujë (2 g/litër). Dy ton/ha gips për tretje kërkojnë 100 mm uji (ujitje apo rreshje). Në këto sasi duhet patur parasysh humbjet nga avullimi. Kështu në se bien 1000 mm rreshje, efektivi për shpëlarje mund të jetë 400-500 mm ose 4000-5000 m³/ha. Në këtë rast sigurohet tretja e 8 ton/ha gips. Krahas rreshjeve në tretjen e gipsit ndikojnë edhe shpëlarjet me ujë dhe ujitjet.

Plugimi i tokës: Në tokat argjilore të rënda në proces shkripëzimi dhe përmbajtje kripe 0.6-1.0 %, çdo vit bëhet plugimi 36-40 cm dhe diskim sipas nevojës. Në tokat nën 0.6% kripë të cilat janë nën kulturë bëhet plugimi 26-30 cm dhe diskim sipas nevojës. Toka punohet në sistem kurriz të lehtë.

Vijat kulluese: Vijat kulluese, si element i rëndësishëm për shkripëzimin e tokave shumë të rënda në fazën e parë hapen çdo vit në thellësi 70-80 cm e largësi sa gjysma e gjerësisë së lehtë të piketimit.

Shpëlarja me ujë: Përdoret si masë plotësuese krahas shpëlarjes nga rreshjet e shiut për largimin e kripërave në tokat me përbërje mekanike të rëndë dhe të mesme që përmbajnë mbi 1% kripra. Kushte për shpëlarjen me ujë është marrja e masave komplekse të njëkohshme, si plugimi, shkrifërimi i thellë, hapja e vijave të thella kulluese, shpërndarja e gipsit, nivelimi sipërfaqësor dhe ndërtimi i oxhaqeve me sipër-

faqe sa ajo ndërmjet dy vijave kulluese me ledhe 60x30 cm. Nuk duhet të lejohet që uji të rrjedhë nga bankinat në vijat kulluese. Norma e ujit për shpëlarje jepet në varësi të përbërjes mekanike dhe shkallës së kripëzimit të tokës. Në tokat me përbërje mekanike të mesme gjatë një sezoni shpëlarës, sipas shkallës së kripëzimit, përdoren nga 4000-6000 m³/ha.

Para fillimit të shpëlarjes toka e pluguar më parë thahet për disa ditë, pastaj mbyllet kokat e vijave kulluese dhe oxhaqet mbushen me ujë. Pas 5-8 orësh, kur niveli i ujit në oxhak arrin 10-15 cm, hapen kokat e vijave kulluese dhe uji lihet që të filtrojë dhe të largohet. Më pas futet dora e dytë e ujit për shpëlarje me normë 1500-2000 m³/ha dhe lihet të filtrohet në tokë. Në rast se uji për 4-5 ditë nuk filtron, largohet nga ngastra duke hapur presa në ledhet e oxhaqeve. Në këtë mënyrë vazhdohet deri në dhënie të plotë të normës së ujit për shpëlarje. Pas përfundimit të shpëlarjes, menjëherë sa të lejohet kushtet, bëhet shkrifërimi sipërfaqësor i tokës për të penguar ngritjen kapilare të kriprave.

Shpëlarja e një ngastre në varësi të përmbajtjes së kripërave zgjat nga 1-2 vjet derisa përmbajtja e kripës të ulet nën 1%. Para dhe pas shpëlarjes ndiqet dinamika e Na të këmbësorëve.

Faza e dytë: Kjo fazë fillon kur tokat pranojnë mbirjen dhe zhvillimin e bimëve. Zgjedhja e bimëve që mbillen në këto toka bëhet mbi bazën e përmbajtjes së kriprave dhe tolerancën ndaj kripëzimit.

Kur toka përmban 0.6-1.0% kripë mbillen bimë tolerante ndaj kripëzimit si festuk, lolium, elb, grurë, tërshërë, sorgum, panxhar, etj. Kusht i domosdoshëm për të siguruar prodhimin e dëshiruar nga bimët është sigurimi i mbirjeve brenda 15 shtatorit, për mbjelljet e foragjereve të vjeshtës dhe brenda 20 tetorit për grurin, elbin, tërshërën, etj. Për të gjithë bimët duhet siguruar ujë gjatë gjithë periudhës vegetative.

Në tokat që përmbajnë më pak se 0.6% kripë bëhet punë më intensive për shëndoshjen biologjike me pleh organik duke përdorur 300-400 kv/ha. Veç përdorimit të plehut organik planifikohet edhe mbjellja e kulturave të dyta për plehërim të gjelbër. Në këtë rast bimët më të përshtatshme janë sezbanja, sorgumi, trifili, tërshëra, batha, soja, etj.

Në tokat me përmbajtje të kripës mbi 1% duhet të shfrytëzohen me serra për kultivimin e perimeve, hardhisë, luleshtrydheve, luleve, etj. Në këtë rast duhet të sigurohet ujë për ujitje me pika dhe drenazhimi i tokave që përdoren për këtë qëllim.

Është rëndësishme të theksohet se toka me faktor kufizues të prodhimit përbëjnë bazat e aktivitetit ekonomik në disa zona bujqësore të vendit. Për këtë arsye problemi i trajtimit të këtyre tokave bujqësore apo kthimi në ekosisteme natyrore të qëndrueshme përbën një problem aktual. Kjo bëhet më imperative, si rezultat i urbanizimit të pakontrolluar e tokave më të mira rreth qyteteve.

Përgatitën:

Dr. Zhaneta Hasani, Msc. Florjana Çela

Drejtorja e Shërbimit të Tokës dhe Ujërave;
QTTB-Fushë Krujë: E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji maj 2022

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Zhvillimi i reve

Muaji maj në Tiranë, shënon ulje të mbulesës së reve, ku përqindja e kohës që qielli është me vranësira ose krye-

Pamja e qiellit gjatë muajit maj 2022

Më 6,7 maj - Dushi meteorik Eta Aquarids. Eta Aquarids është një dush mbi mesa-

Parashikimi i motit për muajin maj 2022 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	11	20	11/22/2019	0	0	7	6	VL	JJP	3	Kohë me re dhe diell	
2	11	21	12/25/2020	0	0	7	6	JJL	JJL	9	Kryesisht me diell	
3	12	21	11/22/2020	3.9	2.5	6	6	VL	VVP	4	Vranësira variabile me ndonjë stuhi me pika pasdite	
4	12	21	12/25/2020	0	0	7	7	VVL	V	9	Pjesërisht me diell	
5	11	22	12/25/2020	0	0	7	6	JJL	JJL	7	Interval i reve dhe diellit	
6	13	21	11/21/2020	12.5	5	9	11	JL	JJL	3	Vranësirë e madhe me disa shira dhe stuhi pasdite	
7	13	22	13-25-20	6.6	3	7	4	JJL	PVP	8	Diell dhe disa vranësira me stuhi rreth pasdites	
8	14	23	15-25-22	12.4	6	4	4	JP	P	4	Kryesisht me re me reshje dhe stuhi	
9	15	23	15-25-21	8	4	9	9	PVP	P	8	Kohë me re dhe diell me disa shira dhe ndonjë stuhi	
10	15	23	16-24-21	3.1	2	13	9	PJP	JP	8	Kohë me re dhe diell me ndonjë stuhi përreth	
11	13	23	14-25-21	0	0	13	7	JP	JP	9	Pjesërisht me diell	
12	14	24	13-26-22	9.1	4.5	11	7	JJP	JJP	9	Kryesisht me re me ndonjë shi të vogël pasdite	
13	13	24	12/26/2022	2	1	9	9	JP	JJP	9	Kohë me re dhe diell me ndonjë stuhi përreth	
14	12	24	14-25-22	2.1	1	11	4	JJP	JJP	9	Kohë me re dhe diell me ndonjë stuhi përreth	
15	13	23	14-24-22	4.5	2	7	7	JP	P	6	Kryesisht me re me ndonjë stuhi	
16	15	24	16-25-22	2.1	1	13	9	P	PVP	9	Kohë me re dhe diell me ndonjë stuhi përreth	
17	15	24	13-27-22	2	1	7	15	VVP	VVL	9	Kohë me re dhe diell me ndonjë stuhi përreth	
18	13	24	11/24/2022	3.9	2.5	17	20	VL	VL	4	Kryesisht me re me ndonjë stuhi	
19	13	25	11/26/2023	0	0	19	17	VVL	VL	10	Kohë me re dhe diell	
20	14	25	15-28-23	0	0	9	6	VVP	PJP	10	Kryesisht me diell	
21	14	25	14-27-23	0	0	11	9	PJP	JJP	10	Plot me diell	
22	17	25	18-27-23	0	0	11	4	JP	P	10	Pjesërisht me diell	
23	16	26	17-28-24	2	1	9	9	VP	VVL	10	Pjesërisht me diell me ndonjë stuhi në zonë	
24	17	28	17-30-26	0	0	9	7	VVP	VVP	10	Pjesërisht me diell	
25	17	28	18-30-27	0	0	11	6	PVP	V	10	Kohë me diell	
26	17	28	17-30-27	0	0	9	9	JP	JJP	10	Kryesisht me diell	
27	16	28	17-29-26	0	0	13	9	JP	P	10	Plot me diell	
28	16	27	15-29-26	0	0	15	13	VVP	VVL	10	Diell pjesën më të madhe të kohës	
29	17	29	18-31-27	0	0	9	6	VVP	P	10	Plot me diell	
30	15	27	16-28-25	0	0	13	7	JP	JP	10	Pjesërisht me diell	
31	14	25	12/27/2023	2.5	1	15	22	VP	V	10	Pjesërisht me diell me ndonjë stuhi përreth	

aren, i aftë të prodhojë deri në 60 meteorë në orë në kulmin e tij. Shumica e aktivitetit shihet në hemisferën jugore. Në hemisferën veriore, shkalla mund të arrijë rreth 30 meteorë në orë. Ai prodhohet nga grimcat e pluhurit të lëna pas nga kometa Halley, e cila është vëzhguar që nga kohërat e lashta. Dushi zhvillohet çdo vit nga 19 prilli deri më 28 maj. Ai do të arrijë kulmin këtë vit në natën e 6 majit dhe mëngjesin e 7 majit. Gjysmëhëna në rritje do të përdorë herët në mbremje, duke lënë qiej të errët për atë që duhet të jetë një shfaqje e shkëlqyer. Shikimi më i mirë do të jetë nga një vend i errët pas mesnate. Meteorët do të rrezatojnë nga yjësia e Ujorit, por mund të shfaqen kudo në qiell.

Më 16 maj - Hëna e plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës nga Dielli dhe faja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar. Kjo fazë do të ndodhë në orën 06:14 UTC. Kjo hënë e plotë njihet nga fiset e hershme vendase amerikane si Hëna e Luleve, sepse kjo ishte koha e vitit kur lulet e pranverës shfaqeshin me bollëk. Kjo hënë është njohur edhe si Hëna e Mbjelljes së Misrit dhe Hëna e Qumështit.

Më 16 maj - Eklipsi total i Hënës. Një eklips total hënor ndodh kur Hëna kalon plotësisht përmes hijes së errët të Tokës, ose ombres. Gjatë këtij lloji të eklipsit, Hëna gradualisht do të errësohet dhe më pas do të marrë një ngjyrë të ndryshkur ose të kuqe gjaku. Eklipsi do të jetë i dukshëm

Treguesit mesatare klimatike gjatë muajit maj 2022

Treguesit	Tiranë	Korçë	Vlorë	Shkodër	Dibër	Gjirokastrë
Temperatura e ajrit						
Mesatare (°C)	21	17	21	21	14	17
